

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5790
E enjte, 30 maj 2019
çmimi 0.40 €

Vendlindja nderon Prof. Dr. Eqrem Zenelajn



Prof. dr. Eqrem M. Zenelajn, dhe drejtori i shkollës "Dëshmorët e Grekocit", Naser Kurtishaj.

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

HOLOKAUSTI, GJENOCIDI DHE SHOAH F.11

Shkruan: Bardhyl
MAHMUTI



AKTUALE


NË PRISHTINË HAPET QENDRA ZHVILLIMORE E MALAZEZVE F. 7

THAÇI: BE-ja I KA MBYLLUR DYERT PËR KOSOVËN F. 7

KOMANDANTI I FSK-së VIZITON USHTRIMIN E PËRBASHKËT 'IMMEDIATE RESPONSE 19' F. 5

EKONOMI

LANSOHET PULLA POSTARE '100-VJETORI I MBROJTJES SË TROJEVE SHQIPTARE - WOODROW WILSON' F. 9



SPORT

SHALA: JUA TREGOJ PROJEKTIN E RI TË ISTOQUT F. 18



FLET PËR "EPOKËN E RE", AFRIM HOTI | FAQE 4-5

Zgjedhjet nuk e ndryshojnë qasjen e BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Afrim Hoti, e ka quajtur lajm të mirë për vendet e Ballkanit Perëndimor rezultatin e zgjedhjeve në Bashkimin Evropian (BE). Ai ka thënë se me fitoren e forcave pro evropiane nuk do të ketë bllokim të procesit integruar. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoti ka deklaruar se qasja e BE-së do të jetë e

ngjashme ndaj Kosovës dhe vendeve të tjera të Ballkanit. Ai nuk e ka hedhur poshtë mundësinë që në takimin e Këshillit të Ministrave të BE-së në qershor të merret një vendim pozitiv për liberalizimin e vizave për Kosovën. Hoti ka folur edhe për dialogun Kosovë - Serbi, duke thënë se roli dhe pozita e ShBA-së është e pakontestueshme në këtë proces

Lëshohet për qarkullim autostrada 'Arbën Xhaferi'

Me ceremoni shtetërore është bërë të mërkurën inaugurimi i autostradës "Arbën Xhaferi", e cila shtrihet nga Prishtina në Han të Elezit, në kufi me Maqedoninë e Veriut. Në ceremoninë e inaugurimit kanë marrë pjesë presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri Veseli,

kryeministri Ramush Haradinaj, kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, kryeparlamentari Talat Xhaferi dhe kryeministri i Malit të Zi, Dushko Markoviq. Kjo autostradë, me gjatësi prej 65 kilometrash, njihet për urën më të gjatë në rajon me gjatësi prej 5.7 kilometrash



Komisioni Evropian: Kosova ka shënuar përparim në zbatimin e disa reformave | FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

ShBA-ja dhe Gjermania mbështesin anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO

SHKUP, 29 MAJ - Maqedonia e Veriut ka bërë reformat e duhura për të qenë anëtare e plotë e NATO-s andaj e ka mbështetjen e plotët të ShBA-së. Kështu deklaroi ushtruesja e detyrës ambasadore e ShBA-së në Shkup, Mikaela Shvajcer-Bllum. "ShBA-ja dëshiron ta shohë Maqedoninë e Veriut së shpejti si anëtarin e 30 të NATO-s. Kur kjo të ndodhë ne nuk do të jemi partnerë, por do të jemi aleatë, do të vendosim marrëdhënie më të thella dhe përkushtim të ndërsjellët", tha Mikaela Shvajcer-Bllum, u. d. ambasadore e ShBA-së.

Mbështetjen ndaj Maqedonisë së Veriut në strukturat euroatlantike, por edhe për integrimin në BE, e përsëriti edhe ambasadori i Gjermanisë, Tomas Gerberih. "Procesi reformues duhet të vazhdojë dhe të thellohet, të tejkalohet ndarja etnike, ndërsa për këtë duhet më tepër të punojnë edhe përfaqësuesit e bashkësive ndëretnike. Ndërsa për reformat e shtetit duhet të fokusohen të gjithë në vend", u shpreh Tomas Gerberih, ambasador i Gjermanisë në Shkup. Kryetari i Parlamentit të Maqedonisë Veriore, Talat Xhaferi,

deklaroi se pret që në qershor Senati amerikan ta ratifikojë Protokollin dhe vendi këtë vit të jetë anëtare e 30 e NATO-s. "Mendoj se edhe vizita e parë e Këshillit Veriatlantik, në krye me sekretarin e përgjithshëm Jens Stoltenberg, nuk është vetëm vizitë protokollare por, para së gjithash, ka rëndësi thelbësore që i përket veprimtari të ardhshëm si anëtare e NATO-s", theksoi kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi. Për disa ditë në Maqedoninë Veriore do të mbahet stërvitja ushtarake "Goditja vendimtare", e cila do të jetë një nga stërvitjet më



të mëdha që nga pavarësia. Ndërkaq të hënën sekretari i përgjithshëm Jens Stoltenberg dhe Këshilli Veriatlantik i Aleancës do të qëndrojnë për vizitë zyrtare në Shkup.

Gjermania ende pa opinion zyrtar për negociatën Shqipëri - BE

Derisa Raporti i Komisionit të BE-së rekomandon çeljen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, qeveria gjermane ende nuk ka krijuar një opinion unik për çeljen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut



BERLIN, 29 MAJ - Raporti i komisionit të BE-së rekomandon çeljen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, por ky rekomandim duhet të shqyrtohet tani në 28 shtetet anëtare, njëri prej të cilëve është Gjermania. Qeveria gjermane ende nuk ka krijuar një opinion unik për çeljen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, ndërsa ministri socialdemokrat i Evropës, Michael Roth, rekomandon qartazi çeljen e negociatave, kabineti i kancelares Angela Merkel pret progresraportet që

ta shqyrtojë më hollësisht vendimin e komisionit. E pyetur në konferencën e rregullt për shtyp nga DW për këtë çështje, zëvendëszydhënësja e qeverisë gjermane, Martina Fietz, tha se "do ta analizojmë me kujdes dhe pastaj do të shohim se cilat janë konkluzionet operative që do të ndërmerim". Por sikurse i ka deklaruar agjencisë gjermane të lajmeve DPA, kryetari i Komisionit të Bundestagut për Evropën,

deputeti kristiandemokrat Gunther Krichbaum, nga ana e unionit konservator "mund të jetë tetor kur të merret një vendim". Sipas tij, "sigurisht që s'pritet gjë" me një votë pozitive të 28 vendeve anëtare në mes të qershorit. Në prag të publikimit të progres-raporteve të Komisionit të BE-së për gjashtë vendet e Ballkanin Perëndimor, ministri gjerman i shtetit, Michael Roth, i është drejtuar opinionit gjerman me një koment të botuar

në Frankfurter Allgemeine Zeitung. Michael Roth, i cili është edhe vetë deputet socialdemokrat, por edhe përgjegjës për politikën gjermane në Bashkimin Evropian, ka përsëritur kërkesën për çeljen e negociatave të BE-së me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Në pjesën për Shqipërinë, ministri i Shtetit thotë se "në vështrim të parë situata mund të duket më e komplikuar. Por arsyeja është sepse opozita ia del vazhdimisht që të

prodhojë tablo dramatike - në vend se të garojë me qeverinë me ide konstruktive në parlament, të cilin për momentin e bojkoton". Roth tërheq vëmendjen se kjo politikë e papërgjegjshme penguese nuk duhet të fshehtë atë që ka arritur vendi. Duke përmendur këtu reformën e drejtësisë, bashkëpunimin e suksesshëm të organeve shqiptare të sigurisë, me partnerët gjermanë, austriakë dhe italianë si dhe rishtazi me agjencinë kufitare të BE-së, Frontex.

Basha: Rama e di që negociatat nuk hapen në qershor

TIRANË, 29 MAJ - Nga Fieri ku zhvilloi një takim me mbështetës të Partisë Demokratike, lideri demokrat Lulzim Basha nuk ishte fare entuziast lidhur me rekomandimin për hapjen e negociatave me BE-në teksa tha me siguri të plotë se në qershor nuk kanë për t'u hapur negociatat për Shqipërinë. "Këtë e dinë të gjithë në Shqipëri, e dinë të

gjithë në Bruksel. Partnerët tanë ia kanë bërë të qartë atij, siç më kanë informuar edhe mua, se në gjendjen aktuale Komisioni Evropian i qershorit do të votojë për moshapjen e negociatave dhe ky është një ndëshkim për Edi Ramën", tha Basha. Sipas kryedemokratit, Rama i druhet hapjes së negociatave pasi, siç ka thënë ai, e di se vendet ku janë

hapur negociatat të parët që e pësojnë janë politikanët që kanë abuzuar me pushtetin. "Ai e ka frikë hapjen e negociatave. E di shumë mirë se në vendin ku janë hapur negociatat të parët që kanë dalë para drejtësisë janë pushtetarët që kanë abuzuar me pushtetin. Ai po bën gjithçka për të mos hapur negociatat", tha Lulzim Basha.



Komisioni Evropian (KE) ka publikuar raportin e zgjerimit për vendet e Ballkanit Perëndimor

Komisioni Evropian: Kosova ka shënuar përparim në zbatimin e disa reformave

Në raportin e ri për Kosovën, Komisioni Evropian ka vlerësuar se Kosova ka shënuar përparim në zbatimin e disa reformave kryesore të lidhura me BE-në, veçanërisht në lidhje me përmirësimin e sundimit të ligjit dhe administratës publike. Në këtë raport Kosova është kritikuar për shkak të vendosjes së taksës 100 për qind ndaj importeve nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina. Ndërsa Qeveria e Kosovës ka vlerësuar se raporti paraqet të arriturat dhe sfidat që ka Kosova



për këtë çështje, duke thënë se raporti ofron një vlerësim të drejtë dhe të balancuar. Sipas saj, ky raport njih përparimin e bërë në Kosovë, në veçanti në reformat evropiane, sundimin e rendit dhe ligjit dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. "Më lejoni t'i jap përgëzimet. Me Raportin e sotëm të Progresit, Komisioni Evropian konfirmon zotimin për zgjerim, gjithashtu kemi konfirmuar se nuk ka rrugë të shkurtër për në BE, por ka ende boshllëqe", ka thënë Apostolova në një konferencë për medie.

Kosova mirëpret raportin

Zyrtarët e lartë shtetërorë të Kosovës kanë pranuar raportin e Komisionit Evropian, duke vlerësuar se ai paraqet një vlerësim real të të arriturave në Kosovë. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, pasi ka pranuar raportin nga përfaqësuesja e Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka deklaruar se Kosova është e përkushtuar për ta rritur përparimin edhe në rrugën e saj të integritimit evropian. "Presim që edhe të rinjë dhe të gjithë qytetarëve tanë, që me Komisionin e ri t'u njihet e drejta legjitime për të lëvizur lirshëm në tokën e cilës i takojmë, në kontinentin e vet evropian. Ndërkaq ne do t'i marrim përgjegjësitë që na përkasin. Jemi të vetëdijshëm që kemi shumë për të bërë, por do të punojmë edhe më fuqishëm së bashku, me të gjithë segmentet e shoqërisë sonë", ka theksuar Veseli. Ai ka thënë se lufta kundër korrupsionit dhe për sundimin e ligjit do të jetë e pakompromis. Më pas, Apostolova raportin ia ka dorëzuar edhe kryeministrit Ramush Haradinaj dhe ministres së Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha. Kryeministri ka thënë se raporti paraqet edhe të arriturat dhe sfidat që ka Kosova. "Është një raport me të gjetura të përziera, në raste të caktuara ka vlerësim pozitiv për përparimin e arritur, në raste të tjera ka kritika, ka kritika si shembulli për taksën por, përgjithësisht, është raport

Kosovës, në përgjithësi vlerësohet se Kosova nuk ka treguar vullnet politik për avancimin e rrugës së saj integruese. Është bërë përparim i kufizuar në zbatimin e reformave evropiane, por ky përparim ka mbetur nën hijen e vendosjes së tarifës 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjës. Tarifa është vendosur në kundërshtim me marrëveshjen CEFTA dhe frymën e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit", është thënë në komunikatën për medie të këtij instituti. Sipas EPIK, Kosovës i duhet të ndërtojë konsensus politik për ta avancuar rrugëtimin e saj integruese, në veçanti duke u angazhuar në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, largimin e tarifës 100 për qind dhe shtimin e zbatimit të MSA-së. Lëvizja Vetëvendosje ka thënë se raporti për Kosovën ka vlerësuar se në Kosovë ka keqeverisje. Sipas kësaj partie, duke parë qeverisjen aktuale, s'duhet të lejohet të pritet edhe raporti i vitit të ardhshëm, por të rrëzohet qeverisja aktuale. "Ky dokument i rëndësishëm i publikuar nga Komisioni Evropian, edhe sivjet e përsëriti atë që secili qytetar tashmë e pohon për institucionet e Kosovës, e veçanërisht për Qeverinë dhe sistemin gjyqësor e prokurorial. Shumë pak ose aspak përparim, vërejtje të shumta për mungesën e plotë të luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, paaftësinë për t'i eliminuar punësimet abuzive, mungesën e rritjes së vendeve të punës si dhe aspak përparim në çështjet e zhvillimit ekonomik", është thënë në komunikatën për medie të LV-së.

Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut marrin rekomandimin pozitiv

Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë marrë rekomandimin pozitiv nga Komisioni Evropian për hapjen e bisedimeve për anëtarësim. Komisionari për Zgjerim i Bashkimit Evropian, Johannes Hahn, gjatë prezantimit të raportit ka theksuar se dy vendet, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, kanë shënuar përparim dhe reforma në sundimin e rendit dhe ligjit. "Maqedonia e Veriut është i vetmi vend në rajon që nuk ka asnjë konflikt bilateral me vendet fqinje. Sa i përket zbatimit të reformave, dëshiroj ta theksoj forcimin e gjyqësorit si dhe themelimin e sistemit për parandalimin e korrupsionit që janë bërë në mënyrë të rregullt", ka thënë Hahn. Ai ka lavdëruar edhe përparimet që

ka bërë Shqipëria gjatë kohës ndërmjet publikimit të raportit të vitit të kaluar dhe raportit të këtij viti. "Shqipëria në veçanti ka ndjekur një transformim të sistemit të drejtësisë, përfshirë edhe një vlerësim të gjyqtarëve dhe prokurorëve, procesi i vettingut është fundamental për etiketimin e korrupsionit, po ashtu ristrukturimi i gjyqësorit ka filluar mirë si dhe përpjekjet për luftën kundër korrupsionit", ka theksuar Hahn. Pakoja e zgjerimit paraqet dokumentin më të rëndësishëm për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë, ku objektivist përçaktohet gjendja faktike në çdo vend dhe vlerësohet përparimi, por edhe mangësitë për përmbushjen e kritereve në ecurinë e integritimit.

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 29 MAJ - Komisioni Evropian ka publikuar të mërkurën pakon vjetore të zgjerimit për vendet e Ballkanit Perëndimor, ku ka evidentuar sfidat dhe të arriturat e këtyre shteteve. Në rastin e Kosovës, raporti vjetor i zgjerimit ka vlerësuar se Kosova ka bërë përparim në zbatimin e disa çështjeve dhe reformave kyçe të lidhura me BE-në, veçanërisht në lidhje me përmirësimin e kuadrit ligjor në Kosovë, në fushën e sundimit të ligjit dhe të administratës publike.

Komisionari për Zgjerim i Bashkimit Evropian, Johannes Hahn, gjatë prezantimit të këtij raporti, ka theksuar se vendimi i Qeverisë së Kosovës për aplikimin e tarifës 100 për qind për importet nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina e ka dëmtuar bashkëpunimin rajonal. Ai ka kërkuar edhe një herë nga Kosova që të fokusohet në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) dhe ta heqë taksën 100 për qind ndaj importeve nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina. "Kosova duhet të fokusohet në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit dhe theksohet ta heqë taksën prej 100 përqindësh për importet nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina. Në qershor do ta bëjë edhe një përpjekje për të zhbllokuar këtë situatë duke shkuar në këto vende, ndoshta për të përgatitur diçka për 1 korrik (Samiti në Paris). Nuk e di nëse do të jetë e dobishme, por duhet ta përdorim çdo mundësi dhe të bëjmë çdo gjë që është e mundur për ta zhbllokuar këtë situatë që po pengon jo vetëm zhvillimin e këtyre dy vendeve, por tërë rajonin", ka thënë Hahn. Në raport është thënë se Kuvendi i Kosovës ka qenë i suksesshëm në përmbushjen e disa prej çështjeve strategjike të Kosovës, përfshirë këtu ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi dhe miratimin e reformave të rëndësishme legislative. Megjithatë, raporti ka theksuar aktivitetin e vonuar legjislativ të Kuvendit për shkak të funksionimit të dobët, i shkaktuar nga mungesa e shpeshtë e kuorumit. Sa iu përket reformave të admin-

istratës publike, të gjeturat e raportit thonë se është shënuar përparim në miratimin e pakove të ligjeve mbi funksionimin dhe organizimin e administratës publike.

Më tutje, në raport theksohet se korrupsioni mbetet shqetësim në Kosovë, ndërsa ka shënuar përmirësim në hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit në nivel të lartë. "Kosova ndodhet në fazë të hershme në luftimin e korrupsionit. Ka shënuar përmirësim përmes reformave kyçe legjislative në fushën e sundimit të ligjit dhe hetimit dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të shkallës së lartë", është thënë në raportin e KE-së për Kosovën. Për më tepër, raporti në fjalë ka treguar se Kosova është në fazë të hershme në luftimin e krimit të organizuar. "Masat janë të nevojshme që të mos ketë ndërhyrje politike në aktivitetet operuese të trupave të zbatimit të ligjit dhe prokurorisë. Situata në veri të Kosovës, në aspektin e krimit të organizuar, vazhdon të jetë sfiduese për trupat që merren me zbatimin e ligjit", është thënë në këtë raport.

Raporti përmend edhe procesin e dialogut Kosovë - Serbi. "Sa i përket normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë, Kosova ka vazhduar të jetë e angazhuar në dialogun. Megjithatë, Qeveria e Kosovës duhet t'i tërheqë tarifat e vendosura ndaj importeve të Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës. Kosova duhet të bëjë më shumë përpjekje për një ambient më të favorshëm për të arritur një marrëveshje ligjërish të obligueshme me Serbinë. Kjo marrëveshje është urgjente dhe vendimtare në mënyrë që Kosova dhe Serbia të avancojnë në rrugëtimin e tyre evropian", është thënë në raportin e KE-së për Kosovën.

Sa i përket liberalizimit të vizave, Komisioni Evropian ka ripërsëritur qëndrimin se Kosova ka përmbushur kriteret për liberalizimin e vizave. Sidoqoftë, raporti ka ftuar institucionet e Kosovës ta vazhdojnë përmbushjen e kritereve që dalin nga udhërrëfyesi për liberalizimin e vizave, me theks të veçantë në sundimin e ligjit dhe migrimin.

Edhe shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka folur në Prishtinë

Flet për "Epokën e re", Afrim Hoti

Zgjedhjet nuk e ndryshojnë qasjen

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Afrim Hoti, e ka quajtur lajm të mirë për vendet e Ballkanit Perëndimor rezultatin e zgjedhjeve në Bashkimin Evropian (BE). Ai ka thënë se me fitoren e forcave pro evropiane nuk do të ketë bllokim të procesit integruar. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoti ka deklaruar se qasja e BE-së do të jetë e ngjashme ndaj Kosovës dhe vendeve të tjera të Ballkanit. Ai nuk e ka hedhur poshtë mundësinë që në takimin e Këshillit të Ministrave të BE-së në qershor të merret një vendim pozitiv për liberalizimin e vizave për Kosovën. Hoti ka folur edhe për dialogun Kosovë - Serbi, duke thënë se roli dhe pozita e ShBA-së është e pakontestueshme në këtë proces

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 29 MAJ - Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Afrim Hoti, ka thënë të mërkurën se rezultati i zgjedhjeve të Bashkimit Evropian është lajm i mirë edhe për Ballkanin Perëndimor.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se qasja e BE-së do të jetë e ngjashme ndaj vendeve të Ballkanit. "Mendoj se paraqesin, para së gjithash, një rezultat të mirë, për faktin se për kohë të gjatë është shpërfaqur një lloj frike që forcat e ekstremit të djathtë do të mbizotërojnë dhe do të fitojnë kësaj radhe në Bashkimin Evropian, për faktin se në vitet e fundit kemi pasur një lloj migracioni të madh i cili ka sjellë ksenofobinë dhe ka ndryshuar qëndrimin e Bashkimit Evropian. Por, përfundimisht, me rezultatin e zgjedhjeve përmbysët kjo teori dhe fitorja e forcave pro evropiane nuk është lajm i mirë vetëm për BE-në, por edhe për Ballkanin Perëndimor që synon të jetë pjesë e BE-së", ka deklaruar Hoti. Sipas tij, mund të ketë vështirësi në procesin e vendimmarrjes, por jo edhe bllokim të procesit integruar.

Hoti ka thënë se BE-ja do të vazhdojë qasjen e njëjtë ndaj Kosovës dhe, sipas tij, pritet të ketë zhvillime pozitive meqë deri më tani i kanë hyrë në hak Kosovës. "Pres që të kemi zhvillime pozitive në këtë pikë sepse Kosovës disa herë i është hyrë në hak në procesin e integritetit. Qasja e BE-së do të jetë pak a shumë e ngjashme ndaj Kosovës. Kriteret dhe kushtet e anëtarësimit dhe liberalizimit mbeten të njëjta dhe kontrolli ndaj përmbushjes së tyre do të

jetë strikt", ka thënë ai.

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare nuk e ka hedhur poshtë mundësinë që në qershor, në takimin e Këshillit të Ministrave të BE-së, të merret një vendim pozitiv për liberalizimin e vizave për Kosovën.

Në këtë intervistë Hoti ka folur edhe për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë duke thënë se roli dhe pozita e ShBA-së është e pakontestueshme në këtë proces. Ai ka deklaruar se në Samitin e Parisit pritet që të vendoset bazamenti i marrëveshjes përfundimtare ndërmjet dy vendeve. "Në Paris do të flitet me terma më konkretë dhe besoj se do të vihet bazamenti i marrëveshjes përfundimtare Kosovë - Serbi", është shprehur Hoti.

"Epoka e re": Profesor, si i komentoni rezultatet e zgjedhjeve në Bashkimin Evropian?

Hoti: Mendoj se paraqesin, para së gjithash, një rezultat të mirë, për faktin se për kohë të gjatë është shpërfaqur një lloj frike që forcat e ekstremit të djathtë do të mbizotërojnë dhe do të fitojnë kësaj radhe në Bashkimin Evropian, për faktin se në vitet e fundit kemi pasur një lloj migracioni të madh i cili ka sjellë ksenofobinë dhe ka ndryshuar qëndrimin e Bashkimit Evropian. Por, përfundimisht, me rezultatin e zgjedhjeve përmbysët kjo teori dhe fitorja e forcave pro evropiane nuk është lajm i mirë vetëm për BE-në, por edhe për Ballkanin Perëndimor që synon të jetë pjesë e BE-së.

"Epoka e re": Bazuar në këto rezultate, cila do të jetë qasje e BE-së ndaj vendeve të Ballkanit?

Hoti: Nuk besoj se do të kemi



ndryshime në kuptimin strukturor për faktin që koalicioni pa dyshim se do të krijohet nga forcat pro evropiane dhe krijimi i një koalicioni të ri do të mund të sillte eventualisht probleme në vendimmarrjen e BE-së në aspektin procedural, sepse nëse deri më tani kemi pasur dy parti kryesore që tradicionalisht kanë marrë shumicën e votave dhe kanë përbërë shumicën parlamentare, kësaj radhe do të kemi të paktën tre ose katër subjekte dhe kjo në kuptimin procedural

normalisht se do ta komplikonte vendimmarrjen në përgjithësi. Në këtë dritë nuk shoh ndonjë ndryshim përmbajtësor sepse të gjitha këto parti kanë për synim integrimin dhe vazhdimin e agjendës evropiane dhe në këtë kuptim nuk shoh ndonjë ndryshim kundrejt Ballkanit.

"Epoka e re": Pra, nuk pritet të ketë ndonjë efekt bllokues sa i përket procesit integruar?

Hoti: Jo unë nuk besoj se do të ketë efekt bllokues, por mund të

ketë vështirësi në vendimmarrje sepse nëse paraprakisht është dashur pëlqimi i dy subjekteve tash do të duhej pëlqimi i katër subjekteve parlamentare. Kjo normalisht se paraqet vështirësi parlamentare, mirëpo në asnjë mënyrë nuk do të ketë bllokada.

"Epoka e re": Cili do të jetë efekti i këtyre zgjedhjeve për Kosovën?

Hoti: Nuk do të kemi shumë ndryshime edhe kundrejt Kosovës. Pres të kemi zhvillime pozitive në këtë pikë sepse

e BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor



"Epoka e re": Liberalizimi i vizave është çështja më e përfolur në këto vite por, së fundi, ka pasur deklarime se pas zgjedhjeve në BE, Këshilli i Ministrave mund të marrë një vendim në qershor. Jeni optimist për një vendimmarrje në favor të Kosovës në qershor?

Hoti: Jam optimist i rezervuar dhe besoj në deklarinimin e evropianeve, se pas zgjedhjeve nuk ka më arsye logjike për ta prolonguar edhe më tutje këtë vendim. Megjithatë, rezervat e mia do të hiqeshin sikur të tregoheshim edhe pak më aktivë në kuptimin e heqjes së çfarëdo dileme që vendet e BE-së do të mund të kishin kundrejt Kosovës. Ne vazhdimisht themi se i kemi përmbushur kriteret dhe me pjesën më të madhe të kësaj pajtohëm edhe unë, por është i nevojshëm një koordinim më i ngushtë i institucioneve tona me secilin shtet të BE-së në mënyrë që të merren, para se gjithash, shqetësimet e tyre. Për shembull, të bisedohet me Francën se cili është shqetësimi i francezëve, nëse është migracioni ilegal ta kthen-

im atë në detyrë, të hartonim raporte dhe t'u dërgonim francezëve se kemi përmbushur jo vetëm në mënyrë deklarative, por edhe në praktikë të gjitha kriteret në mënyrë që ky vendim të merret sa më shpejt që është e mundur. Nuk do të befsohesha që një gjë e tillë të ndodhte në qershor.

"Epoka e re": Meqenëse konstituimi i institucioneve mund të marrë kohë, ka gjasa që kjo vendimmarrje të shtyhet për fundvit?

Hoti: Duhet të kemi parasysh se vetë formimi dhe fillimi i funksionimit të institucioneve të BE-së merr kohë. Prandaj edhe mund të lihet për mbledhjen e radhës që pritet të mbahet diku kah fundit i vitit.

"Epoka e re": Komisioni Evropian të mërkurën ka publikuar raportin për Kosovën. Mendoni se është prezantuar gjendja reale në këtë raport?

Hoti: Në mënyrë fundamentale është përshkrim i situatës. Nuk kam ndonjë koment të theksuar në kuptimin se kemi rënie apo

ngritje sepse raporti përfundimisht tregon atë që, në fakt, Kosova po vuan tash e sa kohë. Në pikat kyçe që janë parakushte për integrim, siç është reforma në administratën publike, thuhet se ka pak përparim. Ajo që ka qenë në thumb të kritikës së brendshme dhe të jashtme është numri i madh i zëvendësministrave, korrupsioni është shumë i përhapur, ndikimi politik qoftë në medie, qoftë në pozita të larta publike mbeten sfida shumë serioze për të cilat besoj se edhe raporti nuk ka dhënë ndonjë vlerësim shumë pozitiv. Ka shumë detyra para vetes për të cilat institucionet e tona duhet të tregojnë përkushtim dhe t'i adresojnë në të ardhmen.

"Epoka e re": Z. Hoti, pas zgjedhjeve, a prisni një impuls të ri të BE-së lidhur me dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë?

Hoti: Kemi një proces hibrid për çështjen e vazhdimin të dialogut. Në muajt e fundit, ndoshta për shkak të zbehjes së rolit të përfaqësueses së BE-së për politikë të jashtme, Federica

Mogherini, stafetën e udhëheqjes së këtij procesi e kanë marrë Gjermania dhe Franca si dy shtete kryesore të BE-së. Por, vërtet është shqetësuese nëse ShBA-ja nuk është e përfshirë në këtë proces sepse historia jonë e re dhe e vjetër ka dëshmuar se asnjë marrëveshje substanciale nuk është arritur pa praninë dhe mbështetjen e ShBA-së. Edhe në këtë që po njihet si marrëveshje përfundimtare roli dhe pozita e ShBA-së është e pakontestueshme.

"Epoka e re": Çfarë pritjesh keni nga Samiti i Parisit?

Hoti: Nëse kalohet sikur në Samitin e Berlinit, mendoj se gjërat do të jenë krejtësisht formale, por unë dua të besoj se vetë fakti i thirrjes së një samiti në mbështetje të samitit paraprak reflekton përkushtimin e vendeve kryesore të BE-së që të shkojmë kah gjetja e një zgjedhje konkrete. Në Paris do të flitet me terma më konkretë dhe besoj se do të vihet bazamenti i marrëveshjes përfundimtare Kosovë - Serbi.

Komandanti i FSK-së viziton ushtrimin e përbashkët 'Immediate Response 19'

PRISHTINË, 29 MAJ (ER) - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtnant Rahman Rama, me ftesë të shefit të Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë, gjeneral Mirko Shundov, po merr pjesë në ditën e vizitorëve të ushtrimit fushor ndërkombëtar të organizuar nga Ushtria Amerikane për Evropë (USAREUR), "Immediate Response 19" në Poligonin Ushtarak të Stërvitjes në Slunj të Kroacisë si dhe do të marrë pjesë edhe në shënimin e 10-vjetorit të anëtarësimit të Kroacisë në NATO.

Gjeneral Rama në këtë aktivitet pati mundësi ta shohë nga afër angazhimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës e përfaqësuar në ushtrim nga pjesëtarë të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSh) dhe Ekipeve për Eliminimin e Mjeteve Eksplozive të Pashpërthyer (EOD), të cilët, krahas shteteve partnere dhe atyre të NATO-s, treguan përkushtim dhe profesionalizëm të lartë në kryerjen e misioneve bazuar në skenarët e ushtrimit. Ky ushtrim, mes të

tjerash, promovon stabilitetin dhe sigurinë në rajon dhe forcon bashkëpunimin dhe rrit besimin në mes të partnerëve. Pjesëmarrja e FSK-së në këtë ushtrim kontribuon në avancimin e kapaciteteve të Forcës si në aspektin e organizimit, përgatitjes dhe të zbakimit të njësiteve jashtë vendit, por edhe të

operimit në mjedis shumëkombësh duke qenë të ndërveprueshëm në të gjitha aspektet e operimit. Në këtë ushtrim po marrin pjesë rreth 1 600 ushtarakë nga 15 shtete, të cilët po zhvillojnë operacione stërvitore në disa lokacione duke filluar nga Kroacia, Sllovenia dhe Hungaria.

Ushtrimi do të realizohet prej datës 20 maj deri më 8 qershor 2019. Kontingjenti i FSK-së, pjesëmarrës në këtë stërvitje, ka shfaqur profesionalizëm dhe motivim të nivelit të lartë duke përfaqësuar denjësisht FSK-në gjatë tërë stërvitjes si dhe duke qenë të barabartë me ushtritë partnere dhe ato të vendeve të NATO-s.



Kosovës disa herë i është hyrë në hak në procesin e integritimit. Zgjedhjet e kanë zhdukur argumentin që e kanë përdorur evropianët se 'kemi dilema në mesin e qytetarëve tanë për dhënien e liberalizimit të vizave për kosovarët sepse po e vuajmë me kurrizin tonë'. Qasja e BE-së do të jetë pak a shumë e ngjashme ndaj Kosovës. Kriteret dhe kushtet e anëtarësimit dhe liberalizimit mbeten të njëjta dhe kontrolli ndaj përmbushjes së tyre do të jetë strikt.

'Afera e spitalit', PDK-ja në këtë rast implikon LDK-në

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 29 MAJ - Nënkrjetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Uran Ismaili ka denoncuar në një konferencë për medie të mërkurën, komplet aferën e spitalit ku janë të përfshirë fajdexhinj, mashtrues që kanë keqpërdorur emra të zyrtarëve politik. Ismaili ka prezantuar kronologjinë e krimit të organizuar, ku sipas tij ka filluar në vitin 2003 nga kryetari i atëhershëm i Prishtinës, Ismet Beqiri. "Afera spitali" është një proces i gjatë, i cili ka filluar në vitin 2003, kur edhe është caktuar lokacioni për ndërtimin e këtij spitali privat në Prishtinë, për të cilin edhe janë bërë mashtrimet që kemi parë në video. Leja është dhënë nga Komuna e Prishtinës dhe është nënshkruar nga kryetari i saj, që asokohe ishte Ismet Beqiri nga Lidhja



Demokratike e Kosovës. Më pastaj, në vitin 2005 është ndryshuar lokacioni duke ju dhënë në shfrytëzim prona në kampusin e QKUK-së nëpërmjet një marrëveshje të nënshkruar nga Sami Hamiti, në atë

kryeshef ekzekutiv i Komunës së Prishtinës", ka thënë Ismaili, duke shtuar se në vitin 2006 Komuna e Prishtinës e jep lejen urbanistike dhe në vitin 2007 aktvendimin për fillimin e ndërtimit të spitalit privat në kom-

pleksin e QKUK-së. "Partia Demokratike e Kosovës, në këtë kohë, përmes Kuvendit Komunal në Prishtinë, kishte kundërshtuar ashpër këtë vendim, duke konsideruar se po lejohej veprimi i një spitali pri-

vat në afërsi të QKUK-së dhe kështu po dëmtohej institucioni më i rëndësishëm shëndetësor në Kosovë", ka thënë ai.

Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK) ka reaguar ndaj akuzave të nënkrjetarit të PDK-së, Uran Ismaili, i cili ka akuzuar LDK-në për përfshirje në "Aferën e spitalit". "Nënkrjetari i PDK-së, Uran Ismaili paska tentuar që të fajësojë zyrtarët e lartë të LDK-së për aferat e partisë së tij. Edhe kjo ndodhë nga të papërgjegjshmit! Në video-incizimet e publikuara ditët e fundit, vërehet qartë që nuk kërkohen mito e fajde për leje të ndërtimit, lokacion të ndërtimit apo për licencë të spitalit. Video-incizimet janë publike, dihet qartë në ato video për çka kërkohet e ofrohet mito e fajde. Aty nuk kemi parë asnjë njeri të lidhur me LDK-në, por me PDK-në", është thënë në reagimin e LDK-së.

UShAF-i përmbyll vitin akademik me hapjen e ekspozitës 'Profesionistët e së ardhmes 4'

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

FERIZAJ, 29 MAJ - Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) të mërkurën bëri hapjen e ekspozitës "Profesionistët e së ardhmes", e cila organizohet për herë të katërt në këtë universitet si dhe përfshirë Lobbyt për studentë. Në këtë ngjarje, studentët shfaqën kreativitetin e tyre përmes punimeve të realizuara gjatë punës praktike dhe pjesëmarrësit shijuan Lobbyin e dizajnuar dhe të realizuar nga studentët përfitues në kuadër të projektit Heras.

Rektori i UShAF-it, prof. dr. Agron Bajraktari, ka falënderuar të pranishmit dhe të gjithë ata që kanë kontribuar në zhvillimin dhe arritjen e sukseseve të universitetit. Ai ka folur për rëndësinë e kësaj ngjarje, bashkëpunimin me industrinë dhe aktorët e tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë. Po ashtu, ka falënderuar në veçanti studentët për angazhimin e tyre për zbulimin e Lobbyt si dhe përfaqësuesit e Heras dhe Agjencinë Austriake për Zhvillim (ADA), të cilët u dhanë mbështetje studentëve për realizimin e këtij



projekt. Po ashtu, rektori ka theksuar se UShAF është në pritje të programeve të reja dhe, sipas tij, së shpejti pritet rritje e programeve dhe numrit të studentëve, stafit akademik dhe administrativ, si dhe ka potencuar se gjatë muajit tetor Universiteti do të pajiset me gjashtë laboratorë të ri. Studentët fitues të projektit për realizimin e Lobbyt (Lorita Rama, Resul Qorrolli, Anduela Kasumaj, Premtim Kamberi), falënderuan rektorin Bajraktari për përkrahjen dhe dekanin e tyre Florit Hoxha

për mbështetjen e vazhdueshme që nga fillimi i realizimit të këtij projekti, si dhe përfaqësuesit e Heras dhe ADA-s për ndihmën në realizimin e ëndrës së tyre. Po ashtu, ata inkurajuan studentët e tjerë që të marrin pjesë nëpër projekte.

Dekani Florit Hoxha ka folur për bashkëpunimin individual me studentë, punën e studentëve, si dhe mundësinë e kryerjes së punës praktike nga ana e tyre nëpër hapësirat e universitetit në mënyrë që të përgatiten për tre-



gun e punës.

Ndërsa Arbëresha Meha nga projekti Heras ka përgëzuar rektorin Bajraktari dhe stafin akademik për përkujdesjen që studentët të fitojnë njohuri që nga viti i parë i studimeve dhe në sajë të kësaj ata po dëshmojnë profesionalizëm. Ajo ka thënë se studentët janë krenaria e universitetit dhe njëkohësisht me fat që janë pjesë e tij. Ndërsa, për bizneset është përparësi që po marrin studentët të përgatitur. Musa Selimi nga Federata e

Sporteve Universitare të Kosovës u impresionua me të arriturat e universitetit dhe ambientin e mrekullueshëm që ka krijuar për studentët, njëherësh shprehu dëshirën që studentët e UShAF të bëhen pjesë e pandashme e kësaj federate.

Profesor Fatih Çetin nga Universiteti i Nigdes në Turqi, i cili po qëndron në UShAF në kuadër të bashkëpunimit ndëruniversitar, ka përgëzuar për organizimin e kësaj ngjarje, duke i cilësuar studentët në nivel të lartë të kreativitetit.

Sokol Bashota dënohet me 6 muaj burgim me kusht

KLINË, 29 MAJ - Pak ditë pasi është zgjedhur kryetar i Degës së PDK-së në Klinë, ish-kryetari i kësaj komune, Sokol Bashota, është dënuar me gjashtë muaj burgim me kusht dhe 1 000

euro gjobë, pasi është shpallur fajtor për mosdeklarim apo deklarim të rremë të pasurisë. Bashota akuzohet se që nga viti 2012 deri më 2015 nuk kishte deklaruar banesën prej 79

metrash katrorë në Prishtinë, makinën "BMW X5" në vlerë 65 mijë euro si dhe qiranë për banesë në shumën prej 3 000 mijë eurosh në vit. Mirëpo dënimi me burgim ndaj

tij nuk do të ekzekutohet, sipas kryetarit të trupit gjyqës, Sylë Lokaj, nëse ai nuk kryen vepër tjetër penale brenda një viti, kurse dënimin me gjobë detyrohet ta paguajë brenda 15

ditësh.

Edhe ish-nënkrjetari i kësaj komune, Enver Berisha, është dënuar me gjashtë muaj burgim me kusht dhe 1 000 euro gjobë.

Në Prishtinë hapet Qendra Zhvillimore e Malazezve

Markoviqi: Malazezët dhe shqiptarët, urë e fortë evropiane

Kryeministri i Malit të Zi, Dushko Markoviq, i cili është pritur nga krerët më të lartë institucional të Kosovës, ka marrë pjesë të mërkurën në ceremoninë e hapjes së Qendrës për Zhvillim të komunitetit malazez në Kosovë. Ai ka theksuar se kjo qendër do t'i kontribuojë forcimit të lidhjeve të malazezëve të Kosovës me shtetin amë, Malin e Zi, për të kultivuar identitetin, kulturën dhe vlerat e veta

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 29 MAJ - Presidenti Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë marrë

pjesë në hapjen e Qendrës Zhvillimore të Malazezve të Kosovës e cila është bërë të mërkurën në Prishtinë, në prani të përfaqësuesve të komunitetit malazez dhe bartësve të tjerë të përgjegjë-



Kryeministrit malazez i dhurohet "Harta e Artë e Kosovës"

Si shenjë vlerësimi për angazhimin e kryeministrit të Malit të Zi, Dushko Markoviq, për paqe dhe stabilitet në rajon, dhe për ndërtimin e marrëdhënieve jashtëzakonisht të mira ndërmjet dy shteteve, kryeministri Ramush Haradinaj i ka dhuruar homologut të tij malazez "Hartën e Artë të Kosovës".

sive institucionale të vendit. Në hapjen e kësaj qendre ishte i pranishëm edhe kryeministri i Malit të Zi, Dushko Markoviq. Kryeministri Ramush Haradinaj pastaj ka pritur në një takim të veçantë kryeministrin e Malit të Zi, Dushko Markoviq, për të cilin ka thënë se ardhja e tij në Kosovë ka dy porosi: hapja e Qendrës për Zhvillim e Malazezëve në Kosovë, që malazezët këtu janë në shtëpinë e tyre dhe do ta kenë përkrahjen e Qeverisë dhe institucioneve të Kosovës; dhe porosia e dytë është inaugurimi i autorrugës "Arbën Xhaferi" që lidh në këtë rast rajonin.

Kryeministri Haradinaj gjatë takimit me homologun malazez ka biseduar për të gjitha temat bilaterale, duke besuar se marrëdhëniet Kosovë - Mal i Zi do të thellohen edhe më tutje për qëllimet e njëjta euroatlantike. Haradinaj e ka njoftuar homologun malazez për të gjitha zhvillimet e fundit

në vend, sundimi i rendit dhe ligjit, përparimi ekonomik, infrastrukturor dhe reformat e përgjithshme në vend. Në këtë takim kryeministri Haradinaj ka potencuar rëndësinë e madhe që ka bashkëpunimi dhe partneriteti me vendet e rajonit në të mirë të zhvillimit të këtyre vendeve dhe të ardhmes së përbashkët evropiane.

Kryeministri Haradinaj ka theksuar se Kosova është e përkushtuar që të avancojë me marrëdhënie bilaterale me Malin e Zi edhe në fusha të interesit të përbashkët dhe takimi i sotëm është dëshmi e fortë e këtij orientimi. Ndërkaq kryeministri i Malit të Zi, Dushko Markoviq, ka thënë se ka kënaqësinë që me kryeministrin Haradinaj të bisedojë për raportet bilaterale në mes dy shteteve dhe hapja e Qendrës Zhvillimore është dëshmi e një miqësie thelbësore dhe të përhershme me Kosovën si respektim i vlerave të tyre që janë vlerë e për-

bashkët euroatlantike dhe shumetnike mes dy vendeve. "Malazezët në Kosovë dhe shqiptarët në Mal të Zi janë dy shtyllat mbi të cilat qëndron ura e bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve tona. Së bashku do të kujdesemi që ajo të mos jetë një urë e paqëndrueshme ballkanike, por një urë e fortë evropiane", ka thënë Markoviq. Ndërkaq kryeparlamentari Kadri Veseli ka uruar përfaqësuesit e komunitetit malazez në Kosovë për këtë qendër dhe ka konfirmuar vazhdimin e mbështetjes institucionale. "Me Malin e Zi kemi interesa strategjike dhe rrjedhimisht jemi të përkushtuar për të ndërtuar raporte edhe më të përafërta midis njëri-tjetrit dhe për ta ndihmuar njëri-tjetrin. Mali i Zi është shtet anëtar i NATO-s. Ne jemi krenarë për bashkëpunimin dhe tejkalimin e çdo mosmarrëveshjeje që mund ta kemi pasur në të kaluarën. Do të kemi vetëm mirëkuptim dhe marrëveshje", ka thënë Veseli.

Thaçi: BE-ja i ka mbyllur dyert për Kosovën

PRISHTINË, 29 MAJ (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar të mërkurën se me procesin e integritimit në Bashkimin Evropian po ndodh ajo që nuk duhet të ndodhte, pasi që BE-ja ka mbyllur dyert për Kosovën. "Kemi përm-bushur të gjitha kriteret për liberalizim. Tash e tre vjet është dhënë rekomandimi për liberalizim, por ende nuk ka vendim nga shtetet anëtare", ka thënë Thaçi.

Këto komente ai i bëri gjatë konferencës '20 vjet pas: perspektivat dhe sfidat për Ballkanin Perëndimor', të organizuar nga

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) dhe Grupi për Hulumtime të Politikave në Ballkan (BPRG). "Jo me fajin tonë është ky izolim, por nga paafhtësia e shteteve të Bashkimit Evropian për të marrë vendim për liberalizimin e vizave", është shprehur Thaçi. Ai ka shtuar se është koha e fundit që të ndalet diskriminimi ndaj këtij procesi. "Është edhe një fyerje për qytetarët e Kosovës por, para së gjithash, paraqet një paragjykim për shtetin e Kosovës për qytetarët me mundësi për pasojë të mëvonshme, sepse njerëzit kur vazhdojnë të qëndrojnë kështu

të izoluar kërkojnë alternativa të tjera", ka thënë Thaçi.

Presidenti Thaçi ka dhënë kritika për ndërkombëtarët të cilët punën që nuk kanë arritur ta bëjnë për 20 vjet për drejtësinë në Kosovë, kërkojnë nga liderët institucionalë ta bëjnë për dhjetë muaj. "Për 20 vjet të tëra bashkësia ndërkombëtare ka pasur në duar të veta drejtësinë në Kosovë, 10 vjet OKB-ja dhe 10 vjet EULEX-i dhe tash 20 vjet ata që nuk e kanë bërë atë kërkojnë që institucionet e Kosovës për 10 muaj ta bëjnë. Po kjo është e pamundur", është shprehur Thaçi.



Lëshohet për qarkullim au

Me ceremoni shtetërore është bërë të mërkurën inaugurimi i autostradës "Arbën Xhaferi", e cila shtrihet nga Prishtina në Han të Elezit, në kufi me Maqedoninë e Veriut. Në ceremoninë e inaugurimit kanë marrë pjesë, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri Veseli, kryeministri Ramush Haradinaj, kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, kryeparlamentari Talat Xhaferi dhe kryeministri i Malit të Zi, Dushko Markoviq. Kjo autostradë me gjatësi prej 65 kilometrash njihet për urën më të gjatë në rajon me gjatësi prej 5.7 kilometrash

EPOKA E ENJTE
Albulena S. MAVRAJ

HAN I ELEZIT, 29 MAJ - Me ceremoni shtetërore është bërë të mërkurën inaugurimi i autostradës "Arbën Xhaferi", e cila shtrihet nga Prishtina në Han të Elezit, në kufi me Maqedoninë e Veriut.

Autostrada "Arbën Xhaferi" është e gjatë 65.5 kilometra dhe, krahas "Bechtel & Enkës", kanë punuar edhe 900 kompani vendore me gjithsej 9 449 punëtorë, duke u bërë gjenerues i vendeve të punës për pesë vjet me radhë. Kjo autostradë ka urën më të gjatë në rajon me gjatësi prej 5.7 kilometrash. Në ceremoninë e inaugurimit kanë marrë pjesë presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri Veseli, kryeministri Ramush Haradinaj, kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, kryeparlamentari Talat

Xhaferi dhe kryeministri i Malit të Zi, Dushko Markoviq.

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se sot është një ditë e veçantë për Kosovën, për shtetin tonë, për shoqërinë tonë, por edhe për tërë rajonin. "Sot po përurojmë një nga projektet më madhore të shtetit të Kosovës, urën më të gjatë në rajonin tonë. Është një investim i fuqishëm, por që ia ka vlejtur, sepse një Kosovë e lirë dhe e pavarur edhe duhet të zhvillohet. Prandaj, nëse dje kemi ëndërruar që të kemi një Kosovë të tillë, sot e kemi realitet. Nëse dje na është dukur e pamundur që të kryejmë projekte të tilla, sot i kemi realitete. Nëse dje këto përvoja i kemi kaluar në botën perëndimore, sot i kemi në Kosovën e re", ka thënë presidenti Thaçi, duke shtuar se kjo është Kosova e re, moderne dhe evropiane.

Veseli: Kosova po ndërton ura fizike dhe miqësie me vendet fqinje

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se shteti ynë pas dy dekadash po dëshmon se është faktor stabiliteti në rajon, duke ndërtuar ura fizike, por edhe miqësie me vendet e rajonit. Veseli ka thënë se Kosova po ndërton rrugë dhe ura që lidhin bashkëqytetarët dhe vendet tona, Republikën e Kosovës me Republikën e Shqipërisë dhe atë të Maqedonisë së Veriut e, po ashtu, së shpejti edhe me Malin e Zi, nëpërmjet një projekti shumë të madh infrastrukturor.

Ai ka shtuar se ky është interes strategjik dhe ekonomik i Kosovës. "Ne po lidhemi edhe me urat e miqësisë, të bashkëpunimit e të fqinjësisë së mirë", ka theksuar kryeparlamentari Veseli.



Duke iu drejtuar kryeministrit të Maqedonisë së Veriut dhe atij të Malit të Zi, të cilët ishin në këtë inaugurim, kryetari i Kuvendit ka pohuar se te Kosova gjithmonë do të gjejnë një partner të veçantë, të sinqertë dhe bashkëpunues me shtetet dhe popujt e tyre. Ai ka theksuar se orientimi i Kosovës do të jetë zhvillimi ekonomik, shteti ligjor, sundimi i ligjit, lufta kundër kimit dhe korrupsionit. "Sot të gjithë po e shohin se Kosova jo vetëm po qëndron financiarisht dhe ekonomisht, por ajo është e fuqishme të bëjë mrekulli. Falënderoj edhe të gjithë përfaqësuesit e vendeve mike të

Kosovës, ambasadorin e ShBA-së, Kosnet dhe secilin ambasador të secilit vend mik. Keni besim në shtetin e Kosovës. Kosova është një vend demokratik, ku sundon ligji. Ajo do të jetë përherë mirënjohëse dhe partnere e juaja", ka deklaruar kryeparlamentari Veseli.

Haradinaj: Autostrada 'Arbën Xhaferi', vepër që i jep peizazh tërë rajonit

"Para 20 vjetësh kjo rrugë e kishte domethënien e braktisjes së atdheut për të kërkuar shpëtim. Sot marrim frymë lirshëm dhe me



Autostrada 'Arbën Xhaferi'



Lekaj: Puna e qeverisë nuk përfundon me autostradën 'Arbën Xhaferi'


Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, duke iu adresuar dhe uruar mirëseardhje zyrtarëve shtetërorë e qytetarëve të pranishëm në këtë ngjarje me rëndësi të madhe për ekonominë dhe qarkullimin e lirë të njerëzve dhe mallrave, ka thënë se kjo autostradë e lidhë Prishtinën me komunat e tjera dhe Maqedoninë Veriore dhe i hap rrugë Kosovës drejt lidhjes me korridorin 10. Ministri Lekaj, duke i falënderuar djemtë dhe vajzat që punuan për ngritjen e këtij gjiganti infrastrukturor, ka thënë se me dhembje kujtohen edhe ata që humbën jetën në punë. Ai ka deklaruar se puna e qeverisë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit nuk përfundon këtu, por me jetësimin e "Autostradës së Dukagjinit", e cila pritet të fillojë së ndërtuari këtë vjeshtë. "Ky

përkushtim shërben si dëshmi se qeveria Haradinaj do të vazhdojë të dëshmojë se punon për mirëqenien e qytetarëve, duke e lidhur Kosovën me familjen evropiane", ka thënë Lekaj.

guxim, shohim përtej fatkeqësisë në të ardhmen prosperuese", kështu ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj gjatë ceremonisë së hapjes së autostradës "Arbën Xhaferi". Kryeministri Haradinaj ka thënë se janë këtu bashkë për t'iu gëzuar kësaj veprë moderne që i jep një pamje të re jo vetëm peizazhit të Kosovës, por të tërë rajonit, si një hapësirë që është ndarë së bashku nëpër shekuj. Kryeministri Haradinaj, gjatë fjalës së tij në këtë ceremoni, ka theksuar se kanë hasur në sfida gjatë rrugëtimit, por nuk janë ndalur, sepse kanë pasur besim jo vetëm në cilësinë e eksper-

tizën e operatorëve, por në të gjithë ata parametra të tjerë që dëshmojnë se është një ndër veprat më të bukura të infrastrukturës në Ballkan. "Janë paratë e taksapaguesve, të qytetarëve të Kosovës dhe ju garantojmë me përgjegjësinë më të madhe, se me respektin më të madh është bërë kujdes, që ky investim të jetë në përputhje me obligimet ligjore që kanë institucionet e vendit, në përputhje me qëllimin e këtij projekti, që sot ta kemi të përfunduar", është shprehur kryeministri Haradinaj, duke shtuar se Kosova po ec me guxim në infrastrukturë.

Lansohet pulla postare '100-vjetori i mbrojtjes së trojeve shqiptare - Woodrow Wilson'



PRISHTINË, 29 MAJ (ER) - Me rastin e 100-vjetorit të Konferencës së Paqes në Paris, Posta e Kosovës ka lëshuar në qarkullim pullën postare "100-vjetori i mbrojtjes së trojeve shqiptare, Woodrow Wilson", dedikuar mikut të madh të kombit shqiptar presidentit të 28 të ShBA-së, Woodrow Wilson, për kontributin vendimtar në mbrojtjen e trojeve shqiptare nga copëtimi i mëtejshëm. Tentimet për ndarjen e trojeve shqiptare u shtuan edhe pas "Konferencës së Londrës". Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me angazhimin dhe urtësinë e presidentit Wilson, i dhanë fund kësaj fushate të egër anti-shqiptare në "Konferencën e Paqes" në Paris më 1919. "Këtë vit shënojmë 100-vjetorin e miqësisë, mirënjohjes dhe falënderimit tonë për përkrahjen jetike nga ShBA-ja, prandaj nuk është e rastit që pulla postare do

të bartë me krenari portretin e Woodrow Wilsonit, mikut të madh të shqiptarëve. Wilsoni lindi më 28 dhjetor 1856, në Staunton të Virginias në ShBA. Ishte një nga presidentët më të mëdhenj të ShBA-së, që udhëhoqi shtetin në periudhën 1913-1921. Ai u angazhua për vendosjen e paqes në botë, për mbrojtjen e të drejtave të popujve të vegjël deri në vetëvendosje. Ishte iniciuesi i themelimit të Ligës së Kombeve", është thënë në njoftimin e Postës. Presidenti Wilson vdiq më 3 shkurt 1924 në Washington D. C. Për aktivitetin dhe kontributin e jashtëzakonshëm të tij për një botë më të mirë dhe më të sigurt, në vitin 1919, u nderua me çmimin Nobel për Paqe. Filatelia e Postës së Kosovës edhe në të ardhmen do të nderojë personalitete të shquara botërore, miq të kombit shqiptar.



Gjilani nis përgatitjet e fundit për 20-vjetorin e çlirimit

GJILAN, 29 MAJ (ER) - Komuna e Gjilanit është duke i bërë të gjitha përgatitjet për shënimin e 20-vjetorit të çlirimit të Gjilanit, i cili do të shënohet më 11 deri më 15 qershor. Këtë e ka konfirmuar të mërkurën drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport në Gjilan,

Shpresa Hajdari, në konferencën për medie, ku ka paraqitur punën e këtij resori nga janari e deri më tani, sikurse edhe planifikimin për tre muajt e ardhshëm. "Në këtë fazë është duke u punuar në përgatitjet për shënimin e 20-vjetorit të çlirimit

të Gjilanit, ku organizimi do të fillojë nga data 11-15 qershor dhe përpos aktiviteteve kulturore, do të bëhet edhe shpallja e më të dalluarve të vitit, shpallja e fituesit të çmimit 'Beqir Musliu', shfaqje teatrale dhe aktivitete të tjera", ka deklaruar Hajdari.



Serbët protestuan në veri

MITROVICË, 29 MAJ - Të mërkurën në Mitrovicën Veriore është organizuar protestë ndaj aksionit të Policisë së Kosovës, i cili është zhvilluar të martën në komunat e veriut të Kosovës.

Protesta e qytetarëve serbë ka nisur në mesditë në Sheshin "Princi Lazar". Kryetari i partisë Lista Serbe, Goran Rakiq, u është drejtuar protestuesve, duke thënë se të martën janë rrahur qytetarët e Zubin

Potokut vetëm pse kanë qenë serbë. Ai ka theksuar se qytetarët serbë të katër komunave të veriut të Kosovës, Zveçanit, Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Mitrovicës Veriore janë të bashkuar dhe nuk janë frikë-

suar nga, siç e ka quajtur ai, "brutaliteti i policisë". "Kërkojmë lirinë, mbrojtjen dhe drejtësinë. Dje kriminelët arrogantë dhe qëllimkeq, të fshehur si policë, kanë përhapur urrejtje dhe dhunë ndaj

popullit duarthatë. Kanë goditur, shkatërruar dhe shembur, kanë shtënë kinse po vendosin rend duke e satanizuar veriun, në mënyrë që ta pushtojnë më lehtë. Kjo sjellje është e turpshme për shqiptarët dhe e turpshme për bashkësinë ndërkombëtare, e cila i promovon të drejtat dhe liritë e njeriut", ka thënë Rakiq. Ai u ka thënë qytetarëve që të mos bien pre e "provokimeve hipokrite të ziera sipas recetës së kuzhinës së madhe perëndimore". Rakiq ka shtuar se "shteti i Serbisë është me serbët e Kosovës dhe do të vazhdojë të jetë me ta".

Në këtë protestë kanë qenë të pranishëm kryetarët e komunave veriore të Kosovës, zyrtarë serbë të këtyre komunave, si dhe drejtues të institucioneve publike, por edhe të strukturave të cilat autoritetet e Kosovës i konsiderojnë paralele dhe jolegale. Protesta ka përfunduar pa ndonjë incident.

Të martën Policia e Kosovës ka zhvilluar një operacion në veri dhe jug të Mitrovicës, me qëllim të luftimit të kimit dhe kontrabandës. Operacioni policor ka rezultuar me ndalimin e 19 zyrtarëve policorë dhe të disa qytetarëve.



Pastrohet lumi 'Toplluha' në Suharekë

SUHAREKË, 29 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije se autoritetet përgjegjëse në këtë komunë kanë filluar ta bëjnë pastrimin e lumit "Toplluha" i cili ka qenë i mbushur me mbeturina.

Muharremaj ka theksuar se pas pastrimit të këtij lumi do të nisnin një fushatë vetëdijesuese për moshedhjen e mbeturinave në lumenjtë e Suharekës. "Lumi 'Toplluha' po pastrohet nga institucionet përkatëse.

Natyrisht, bashkë do të punojmë për vedijësimin e atyre që po hedhin mbeturina dhe po e dëmtojnë imazhin e lumit", ka thënë Muharremaj pas inspektimit që u ka bërë punimeve gjatë pastrimit të lumit "Toplluha". Po ashtu, Muharremaj të mërkurën ka inspektuar punimet që janë duke u bërë në pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve në territorin e kësaj komune, me ç'rast ka bërë thirrje për ruajtjen dhe mbrojtjen e ambientit.



Shtrohet me kubëza rruga në lagjen Kurillë të Prizrenit

PRIZREN, 29 MAJ (ER) - Komuna e Prizrenit ka bërë me dije se janë në përfundim të shtrimit me kubëza të rrugës në lagjen Kurillë. Kjo komunë ka njoftuar se në kuadër të këtij projekti është krijuar edhe rrjeti nëntokësor i energjisë elektrike. "Në lagjen Kurillë këto ditë po zhvillohen punimet e fazës finale për

shtrimin e rrugës me kubëza. Paraprakisht, në këtë rrugë, në koordinim me projektin e KEDS-it, është krijuar rrjeti nëntokësor i kabllave të rrymës elektrike.

Me të përfunduar punimet e infrastrukturës rrugore, do të bëhet kyçja e rrymës elektrike me rrjetin nëntokësor nga ana e KEDS-it", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.

Me të përfunduar punimet e infrastrukturës rrugore, do të bëhet kyçja e rrymës elektrike me rrjetin nëntokësor nga ana e KEDS-it", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.



Shkrim drejtuar gazetarëve dhe atyre që merren me politikë

Holokausti, gjenocidi dhe shoah



**Shkruan: Bardhyl
MAHMUTI**

Në serinë e shkrimeve që kam publikuar dhe që do t'i publikoj me qëllim të harmonizimit të terminologjisë lidhur me krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë sot do të përqendrohem në trajtimin e termeve që në gjuhën e përditshme është bërë e zakonshme të përdoren si të ishin sinonime të gjenocidit. Fillimisht do të ndalem në nocionin "holokaust", që ka një shtrirje në përmasa botërore. Fjala "holokaust", që është me origjinë greke, ka gjetur përdorim të madh që nga shekulli i II para epokës sonë, kur për herë të parë u përkthye në këtë gjuhë Bibla e Judaizmit (Torah).

Në kuptimin biblik të asaj që quhet "Testamenti i vjetër", "holokausti" paraqet një flijim të veçantë që bëhet për hir të Zotit. Veçantia e "holokaustit" qëndron në faktin se kafshët e flijuara nuk hahen, por digjen tërësisht si kushtim për perëndinë. Ky term filloi gradualisht të zërë vend edhe në rastet kur ushtrohej dhuna kundër hebrenjve. Kështu, shkrimtari dhe publicisti francez me origjinë hebraike Bernard Lazare në veprën e vet të titulluar "Antisemitizmi-historia dhe shkaqet e tij" të botuar në vitin 1894 shkruan: "Kur kryqtarët niseshin ta çlironin Kishën e Varrit të Shenjtë, ata përgatitnin luftën e shenjtë me flijimin e hebrenjve; Kur murtaja e zezë ose uria bënte kërdi sakrifikoeshin hebrenjtë si holokaust për perëndinë e zemëruar; kur popullin e tmerorin të këqijat, mjerimi dhe uria ata hakmerreshin kundër hebrenjve; prifti Pierre de Cluny deklaroi se nuk na duhet të shkojmë të luftojmë kundër myslimanëve, kur i

kemi në mesin tonë hebrenjtë, që janë më të këqij se myslimanët. Çka të bëjmë tjetër kundër epidemisë, pos të vrasim hebrenj të cilët bëjnë komplot me të sëmurit nga lebra për të helmuar burimet e ujit. I zhdukim në Jork, në Londër, në Spanjë, në Islandë, në Poloni, në Francë në Moravi, në Austri. I djegin në Strasburg, në Mayance, në Troyes; në Spanjë djegin me mijëra hebrenj; në vende të tjera ua shqyejnë barkun me tërfurk dhe me kosë, i vrasin si qen" (Bernard Lazare, L'Antisemitisme, sonhistoire et ses causes, Edition de l'AAARGH, 2002 1894, f. 62).

Me ardhjen e nazistëve në pushtet në Gjermani populli hebre u ballafaqua me politikën e quajtur "zgjidhja përfundimtare e çështjes hebraike" (në gjermanisht: Endlösung) që kishte për qëllim asgjësimin e të gjithë pjesëtarëve të këtij grupi etnik dhe religjioz.

Duke mos e kuptuar se bëhej fjalë për një program të detajuar për asgjësimin total të hebrenjve, shkrimtari francez me origjinë hebraike Max Jakob, në letërkëmbimet e tij të vitit 1937, përdor termin "holokaust" dhe idenë e një sakrifice kushtuar Zotit. Ai nuk e dinte se do të përfundonte në një varrezë masive.

Nuk ishin vetëm hebrenjtë që nuk gjenin term adekuat për t'i përkufizuar tmerret e planifikuar dhe të ekzekutuara nga nazistët gjermanë ndaj tyre, por askush nuk dinte si ta emëronte atë që ishte duke ndodhur fillimisht me hebrenjtë e më vonë edhe me romët. Si ilustrim do ta përmend kryeministrin e atëhershëm të Britanisë së Madhe, Wilson Churchill. Në një fjalim të mbajtur gjatë vitit 1943 i deklaroi: "Jemi duke parë një krim që nuk ka emër".

Disa muaj pas këtij fjalimi radiofonik të Wilson Churchillit, juristi hebre Rafael Lemkin krijoi fjalën "gjenocid", si nocion i ri për ta emëruar këtë lloj të krimeve. Për këtë neologjizëm, Rafael Lemniku përdori fjalën greke "genos",

që do të thotë "fis" dhe fjalën latine "cide", që do të thotë "vrasje".

Fillimisht termi "gjenocid" përfshinte aktet e dhunës që ishin të drejtuara kundër pjesëtarëve të një grupi kombëtar dhe shumë shpejt ky nocion gjeti një përhapje të madhe, sidomos pas publikimit të shkrimit të Lemnikut të titulluar "Gjenocidi" në gazetën prestigjioze "The Washington Post", të datës 3 dhjetor 1944.

Për historianët e mendimit juridik është me interes të madh të shihen debatet që u zhvilluan lidhur me përkufizimin e këtij krimi, veçanërisht debatet që u zhvilluan në kuadër të sesioneve të Këshillit Ekonomik dhe Shoqëror të Kombeve të Bashkuara. Një sintezë të shtyllave kryesore rreth të cilit artikuloeshin debatet lidhur me çështjen e parandalimit dhe ndëshkimit të krimit të gjenocidit gjendet edhe në studimin e raportuesit special të kësaj organizate (Nicodeme Rughashyankiko (United Nations, Economic and Social Council, Nicodeme Rughashyankiko, Study of the question of the prevention and punishment of the crime of genocide, studim që është në gjuhën angleze dhe atë frënge).

Në këtë shkrim do të kufizohem në rezultat final të këtyre debateve. Miratimi i Konventës për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit, më 9 dhjetor 1948, e shndërroi nocionin "gjenocid" në kategori juridike. Përkufizimi juridik i gjenocidit, si kategori e të drejtës penale ndërkombëtare, zgjeroi fushën kuptimore të akteve të dhunës që mbulon ky nocion. Konventa e lartpërmendur përfshinë në nocionin gjenocid kryerjen e cilit nga krimet e numëruara në nenin II të kësaj konvente: a) vrasja e anëtarëve të grupit; (b) cenimi i rëndë i integritetit fizik ose mendor i anëtarëve të grupit; (c) vënia e grupit qëllimisht në kushte të tilla të jetës, që sjellin zhdukjen e plotë fizike ose të pjesshme të tij; (d) ndërmarrja e masave për pengimin e lindjeve brenda grupit; dhe (e)

transferimi i dhunshëm i fëmijëve nga njëri grup në tjetrin kur krimi është bërë me qëllim që të shkatërrohet tërësisht ose pjesërisht një grup kombëtar, etnik, racor ose fetar, si i tillë.

Pra, përveç dhunës kundër një grupi kombëtar, në nocionin gjenocid përfshihen aktet e lartpërmendura të krimeve, nëse ato kanë për qëllim të shkatërrojnë tërësisht ose pjesërisht edhe një grup etnik, racor ose fetar si të tillë.

Përveç nocionit "gjenocid", termi "holokaust" përdoret për ta emëruar vrasjen e mbi 6 milionë hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Seria televizive amerikane me titull "Holocaust", e realizuar nga Marvin Chomsky në prill të vitit 1978, i dha një shtytje të madhe përdorimit të këtij termi.

Aktualisht me dhjetëra muze anekënd globit përdorin në emërtimet e tyre termin "holokaust". Mirëpo, përdorimi i generalizuar i këtij termi nuk ia shton vërtetësinë kësaj fjale.

Përdorimi i termit teologjik "holokaust", për t'i emëruar krimet e ideologjisë naziste që kishte për qëllim asgjësimin e hebrenjve jo vetëm se është i gabueshëm, por është tejet fytyrës për çdo hebre. Është fytyrës për arsye se krimet më të shëmtuar që kishte ndodhur gjatë shekullit të XX i jepet dimension hyjnor, sikur të kishim të bënim me ndonjë ndëshkim për hir të Zotit. Pikërisht këtu qëndron revolta e madhe e disa autorëve me origjinë hebraike që kërkojnë të dënohet përdorimi i termit "holokaust" për të emëruar këtë krim.

Nocioni i dytë me të cilin është munduar të zëvendësohet termi "holokaust" është fjala hebraishte "shoah", që në disa gjuhë përkthehet me fjalën "katastrofë".

Që nga 12 prilli i vitit 1951 termi "shoah" është emri zyrtar me të cilin shteti i Izraelit emërton tragjedinë që populli hebre përjetoi gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe gjithnjë e më shumë ky term kufizohet vetëm për gjenocidin nazist kundër popullit hebre.

Edhe ky term është përhapur në përmasa botërore falë ekraneve televizive. Pas shfaqjes së filmit dokumentar "Shoah" në vitin 1985, që iu kushtohet vrasjeve masive të hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore, përdorimi i fjalës "shoah" kaloi kufijtë e Izraelit.

Që të kuptohet rastësia e përdorimit të një fjale dhe përhapja e saj në përmasa shumë të mëdha sikur vërtet ta pasqyrojnë realitetin e fenomeneve që mundohet t'i përshkruajë, do të citoj pjesë nga intervista e realizuesit francez të këtij filmi, Claude Lanzmann. Në intervistën me gazetarin e njohur Jean-Pierre Elkabbach, realizuesi i filmit deklaroi se gjatë punës dymbëdhjetëvjeçare për këtë film ai nuk i kishte vënë asnjë emër, sepse mendonte që "nuk mund t'i vihej emër asaj që nuk mund të emërohet. Në fund përzgjedha fjalën hebraike 'shoah', për arsye se nuk e kuptoja domethënien e saj. Shoah është një fjalë të cilën rabinët e kishin gjetur në Bibël dhe që kishte kuptimin e një katastrofe, shkatërrimi dhe madje mund të jetë gjithashtu një katastrofë natyrore. Cunami është një fenomen i shoah" (Intervista e publikuar në gazetën "Liberation" të datës 24 janar 2005).

Përkundër asaj se edhe vetë shteti i Izraelit përdor zyrtarisht termin "shoah", përdorimi i një termi që ka lidhje me katastrofat natyrore për një tragjedi të shkaktuar nga njerëzit, ka revoltuar një numër të konsiderueshëm autorësh hebre.

Në krahasim me "holokaustin", termi "shoah" përdoret shumë më pak në gjuhën shqipe. Megjithatë, nocioni "gjenocid", si kategori juridike e të drejtës penale, është nocioni më adekuat për t'i emërtuar krimet që nuk kanë asgjë të përbashkët me flijimet për perëndinë e as me katastrofat natyrore: nocioni "gjenocid" ngërthen në vete krimet e kryera gjatë zbatimit të një politike që ka për qëllim të shkatërrojë tërësisht ose pjesërisht një grup kombëtar, etnik, racor ose fetar si të tillë.

E rrallë

Konsumoi 246 qese kokainë, 42-vjeçari vdes në aeroplan

Një burrë nga Japonia ka ndërruar jetë në avion pasi konsumoi 246 qese kokainë. Pas autopsisë, e gjithë sasia e lëndës narkotike iu gjet në stomak dhe mjekët konfirmuan se i shkaktoi fryrje të trurit. 42-vjeçari filloi të kishte shenjat e para pasi bënte veprime të dhunshme gjatë fluturimit nga



Bogota për në Kolumbi me një ndalesë në Meksikë.

FOTO E DITES



Të mërkurën është bërë inaugurimi i autostradës "Arbën Xhaferi" me gjatësi prej rreth 60 kilometrash që lidh Kosovën me Maqedoninë e Veriut.

E jashtëzakonshme

Burri gjobitet me 15 000 dollarë pasi kapet me shushunja në aeroplan

Një burrë është gjobitur me 15 000 dollarë pasi u përpoq t'i kontrabandonte mijëra shushunja me valixhen gjatë një fluturimi nga Rusia për në Kanada. Ky person u arrestua në aeroportin



ndërkombëtar të Toronto Pearson. Rreth 4 788 shushunja të egra, të gjalla, u gjetën në një qese të madhe ushqimore të ripërdorshme, thanë zyrtarët e mjedisit kanadez.

BARSOLETA E DITËS



Djali: Zemër, a ke ecur me ndonjë këmbë para meje?
Vajza: Jo zemër, me asnjë, se të gjithë ata kanë pasur vetura.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit ne ora 14:00

"DUMBO" 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min

Rolet: Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.
Regjia: Tim Burton



Ne ora 16:00 dhe 19:00

"AVENGERS; Endgame"

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlett Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.
Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 20:00

"EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE"

Krim/Mister; 1 ore 48 min

Rolet: Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.
Regjia: Joe Berlinger



16.05.2019

"THE HUSTLE"

Komedi

Rolet: Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

Regjia: Chris Addison



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Ndjenja e fajit për një veprim


të kryer ka ditë që ju përndjek. Sot do të kërkonti sqarime nga një koleg.



DEMI

Sinqeriteti që do të tregoni ndaj

një personi të dashur do të vlerësohet sot. Do të arrini t'i thoni një të vërtetë që nuk donte ta pranonte.



BINJAKËT

Të papriturat dhe surprizat

nuk është se ju pëlqejnë shumë. Por, sot do të ndiheni të përkëdhelur dhe të rrethuar me dashuri.



GAFORRJA

Keni pritur mjaft për këto ditë të

qeta dhe mëngjesi i sotëm do t'ju gjejë në shtëpi. Një vonesë e shkurtër mund t'ju prishë disi planet.



LUANI

Ditë pa ndonjë efekt të

veçantë kjo e sotmja. Do të relaksoheni në prani të miqve dhe njerëzve të dashur.



VI RGJËR ESHA

Një lajm i marrë në orët e para

të ditës do t'ju shqetësojë paksa. Edhe pse do të kërkonti përgjigje ato nuk do t'i merrni sot.



PESHORJA

Ju intrigon shumë një person që

sapo ka hyrë në jetën tuaj. Keni mjaft të përbashkëta që do t'i zbuloni me kalimin e kohës.



AKREPI

Me të vegjlit janë ata që do të

kënaqen më shumë me ju sot. Do të jeni në dispozicion të kujt do që do të lozë.



SHIGJETARI

Hamendësimet që po i bëni një

situatë që s'ka ndodhur ende do t'ju shqetësojnë me tepër sesa që duhet. Lërinë gjërat të ndodhin.



BRICJAPI

Keni vendosur të ftoni dike

në një udhëtim me ju. Do të jetë një aventurë e këndshme që do ta shijoni.



UJORI

Kthimi në rutinën e zakon-

shme nuk po ju pëlqen aspak. Do të donit t'i kishit vazhduar edhe ca kohë angazhimet që kishit nisur.



PESHQIT

Jeni shumë të qetë për

ato që ju presin sepse keni programuar gjithçka. Gjërat do të komplikohen rrugës.

Bieberi ndalohet nga policia, por shpëton nga dënimi



Edhe një fërkim me ligjin amerikan e pati ylli i muzikës pop, Justin Bieber, veçse këtë herë shpëtoi pa dënim. Organet e rendit kanë deklaruar se një oficer policie e ndaloi këngëtarin 25-vjeçar në veturën e tij 500 mijë dollarësh

"Lamborgini" për mosposedim të targës së përparme dhe për arsyen se ngjyra e dritares së përparme ishte shumë e errët. Rezultoi se këngëtarja e përdori sharmin dhe famën e tij për ta vazhduar rrugën e tij pa marrë asnjë tiketë dënimi.

Fejohen Rooney dhe Joaquin?



Ajanë fejuar Rooney Mara dhe Joaquin Phoenix? Aktorja 34-vjeçare ndezi dyshime të fejesës pasi është parë me një unazë me diamante në gishtin e unazës së dorës së majtë teksa po blinte disa gjëra ushqimore në Los Anxhelos. Po

ashtu, pas disa ditësh, Rooney dhe aktori 44-vjeçar u panë së bashku në një kurs karateje ku ajo, po ashtu, e kishte unazën në dorë. Ky çift janë lidhur që nga viti 2016, atëherë kur po punonin në filmin "Mary Magdalene".



Bebe Rexha përfundon në spital

Bebe Rexha ka përfunduar në spital. Këngëtarja ka publikuar një fotografi në "Instagram" nga spitali, e veshur me rrobat e spitalit. "Jam mirë, faleminderit Zotit", ka shkruar Bebe, e cila nuk ka treguar arsyen përse ndodhet në spital.

Nuk dihet nëse ajo ka pasur probleme shëndetësore apo do të jetë pjesë e një videoklipi të ri. Bebe ka paralajmëruar së fundmi se do ta sjellë bashkëpunimin me The Chainsmokers. Kënga do të publikohet më 31 maj.

Miley Cyrus më 31 maj publikon albumin "She is coming"



Ylli i Holliwoodit, Miley Cyrus, më 31 maj do ta publikojë albumin "She is coming". Në këtë album këngëtarja do të ketë edhe disa

bashkëpunime me Ghostface Killah, Swae Lee dhe Ru Paul. Lajmin e ka bërë me dije vetë këngëtarja përmes profilit të vet në "Instagram".



Autor: GAZMEND MORINA		VENDOSJA E DIÇKAJE NË NJË VEND	VIJË E HAPUR NGA UJËRAT E SHIRAVE	ERA E KËNDSHME	AKTORI AMERIKAN RICHARD (shqip.)	PËRCAKTIMI I NUMRIT RENDOR TË REGJISTRIT; REGJISTRIMI	ZANORE	PËRFUNDIMI TEORIK, QË NXIRRET NËPËRMJET PËRFUNDIMIT SHKENCOR	SHKOJ, ECI (bised.)	VLERË, DOBI (krah.)	EPOKA E RE	PRODUKT ZJARRI
QË PRANON SI TË VËRTETË VETËM ATË QË ËSHTË E DOBISHME											BASHKËT. PERSON QË KA PASION PATOLOGJIK VËNIEN E ZJARREVE	
KLUB I YNI FUTBOLLI							SKUADRA SPORTIVE I GJYMTUAR					
ZBUTJA OSE DOBËSIMI I NJË LËKUNDJE A GODITJE												BISKOTË E GATUAR ME ARRA (sh.shq.)
BASHKËT.			KËNGËTARJA KËRÇELI I ÇMPREH						EPOKË (shq.) ADEM JASHARI			
AKTORJA AMERIKANE FARROW					DY ZANORE MA JEP			GRIMCA MË E IMËT E ÇDO ELEMENTI				
ALBERTO TOMBA				AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT BASHKËT.				JEMENI REOMIR, IRIDIUM		MARC ANTHONY MUZIKANTI KRASNIQI		
QË BËHET SIPAS NJË NORME TË CAKTUAR; I									DRU MESDHETAR			
EPOKA E RE	EMËR MASHKULLI TË KRISHTERË	MODELJA JONË ÇUNMULAJ	SUPER MODELJA AMERIKANE CRAWFORD (shqip.)	PASIMI (Sport)	OKSIGJEN, NEON	ISMET PEJA "N" pas dy "T"		GJASHTARE PËRGËZIM		NËNË (krah.) QYTET NË MAQEDONI		
SUNDIMTAR ME PUSHTET ABSOLUT E TË PAKUFIZUAR						DY ZANORE		I PJEKURI; I MATURI KËNGËTARJA PERUANE ... SUMAK			BASHKËT. PRAPAVEP-RUESE	
LLOJ MINERALI QË PËRDORET PËR PLLAKA IZOLIMI						BURRA TË GUXIMSHËM DERA E VOGËL E THURUR ME THUPRA			FUTBOLLISTI ULIKS QË KA TË BËJË ME ILIRËT DHE ROMAKËT			
AKTORI FRANCEZ NË FOTO CASSEL (shqip.)						INVA MULA DY (turq.)		RITUAL TEFIK OSMANI		ELIZABETH TAYLOR SELEN		
SHTET I MADH NË AZI					FUTBOLLISTI BAJRAMI (TWENTE)	VARGJET E PËRPTHURA SHAMATA			HUMBUR (ang. orgj.) NOTË MUZIKORE			I ÇMENDUR
BURRË TRIM E BUJAR				I EPIKËS PRARQJ		FUTBOLLISTI ARGJENTINAS PABLO (BENFICA)	HISTORIANI ZVICERAN SCHMITT (shq.) KRIMB I DRURIT					
EPOKA E RE	GAZETARJA SHQIPTARE TARE	LLOJ SHEQERKE	LLOJ GAZI ME ERË TË KEQE E TË FORTË VEGËL MUZIKORE (sh.shq.)					TOKA E BUKËS REGJISORI QOSJA		OLIVER KAHN DY BASHKËTINGËLLORE		
I TURPËROVA						AXHAMI SMALTI		ZANORE KOHË KUR NIS TË ZBARDHË DITA (sh.pashq.)		ILAÇ		
KTHESE RRUGË OSE LUMI						I DËRGUAR SPECIAL EMËR FEMRE MYSLIMANE				MJET PËR TË RRËSHQITUR MBI BORË BASHKËT.		
MBYS DIKË ME ARMË ZJARRI					KËNGËTARJA VALENTINA KUDRET ISAI		NIS TË ZBARDHË DITA ELIZA HOXHA			DY BASHKËTINGËLLORE SHKRONJA XVIII		
"R" pas dy "A"				VEND I HAPUR NË MURIN E NJË SHTËPIE SILIC				ISMET MUNISHI KRYEMURG		BREJTËSI I VOGËL RYSHFET		
EPOKA E RE	FEMRA E ZGJEDHUR HARK, KTHESE				IRMA LIBOHOVA TRUP GJEOMETRIK	BANJË ALLATURKA NDËRTIM ME TË CILIN RRETHOJMË OBORRIN				VENEZIA, ROMA KRAHINË NË SHQIPËRI		
ROKERI AMERIKAN KRAVITZ (shqip.) FORTESE					VEPËR E KRIMINELIT RIFAT ISMAJLI		KUNDREJT MALLKIME "RISANI"					TEFTA TASHKO
→				RETURN ON EQUITY BASHKËT.			GODINA MBI UJË BASHKËT.		SHKRONJË GREKE AUSTRIA		TOTENHAM ZANORE	
AKTORJA HOLIVUDIANE ZETA JONES (shqip.)						KLUB I YNI FUTBOLLI			PEZMATIM I VESHIT			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo
Agency of Statistics

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenin 6 pika 5 dhe nenin 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 për kushtet dhe Mënyrën e Ofrimit të të Dhënave të Fituarave me Përpunime të Veçanta të Statistikave Zyrtare si dhe nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Agjencia e Statistikave të Kosovës, bënë:

Shpallje të Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit	Agjencia e Statistikave të Kosovës
Titulli i punës:	Zhvillues i Aplikacioneve
Numri i referencës:	ASK-DMTI-001
Tarifa e shërbimit:	950 Euro (Bruto)
Raporton te:	Udhëheqësi i Divizionit të TI-së
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta - (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	2 muaj
Orari i punës:	I plotë ?
Lokacioni dhe numri i ekzekutuesve:	ASK-1

ASK respektivisht Departamenti i DMTI-së është duke ndërtuar një sistem për Menaxhimin e Metadave. Ky sistem do të jetë kompatibil me sistemin e Eurostatit i tillë që do të mundësojë ASK-së që të dërgojë metadatat kombëtare në Eurostat përmes sistemit Metadata Handler (ESS-MH), dhe si i tillë do të jetë në përputhje me SDMX. Sistemi do të gjenerojë skedarë të metadave në formatin .xml në përputhje me SDMX për të lehtësuar lidhjen me ESS-MH. Në mënyrë që ASK të përmbush këto objektiva, shpall konkurs për një Zhvillues i Aplikacioneve.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Bashkërendon dhe ofron ndihmë për krijimin e strukturave dhe përmbajtjen e të dhënave të SDMX.
- Bashkëpunon me udhëheqësin e projektit për Metadatat për tu siguruar që çdo çështje teknike të zgjidhet.
- Ndihmon në iniciimin e projekteve të reja të shkëmbimit të të dhënave në formatin SDMX.
- Merr pjesë në grupin e punës të SDMX dhe në grupet specifike të lidhura me detyrat e punës. Kjo përfshin bashkëpunimin me ekspertet e Eurostatit të nën kontraktuar nga GOPA për të hartuar udhëzime dhe dokumente të praktikave më të mira për përdorimin e SDMX.
- I ndihmuar dhe mbikëqyrur nga zyrtari përgjegjës i TI-së së ASK-së, do të zhvillojë një bazë të dhënash për metadatat në një server të dedikuar enkas për këtë qëllim.
- Ndërfaqja do të jetë bazuar në ESMS dhe ESQR.
- Ndërfaqja do të dizajnohet dhe zhvillohet në një ndërfaqe miqësore që do të jetë e lehtë për tu qasur;
- Bënë dokumentimin e projektit;
- Në mënyrë rigorozë zbaton masat e sigurisë dhe planeve të rikuperimit të të dhënave;
- Në mbikëqyrje të stafit lokal të TI-së, instalon, konfiguron dhe teston ueb aplikacionin në serverin e ASK-së;
- Bashkëpunon me grupet tjera punuese si dhe ndihmon në kontrollimin, krahasimin, analizimin dhe komentimin e të dhënave dhe rezultateve të tyre.

Shkathësitë e kërkuara:

Diplomë Universitare në fushën e Teknologjisë Informative.

Së paku 4 vjet përvojë punë në fushën përkatëse (e obligueshme).

Kompetenca dhe aftësitë:

- Njohja e gjuhëve koduese siç: C#, HTML, CSS;
- Njohuri të avancuara në teknologjitë ASP.NET, MVC si dhe Microsoft SQL Server;
- Njohuri në standardet e SDMX përparësi;
- Shkathësi në planifikim, hulumtim dhe analiza, kapacitet për të kuptuar proceset, për të koordinuar dhe organizuar punët;
- Ruajtja e konfidencialitetit;
- Të jetë i motivuar dhe aftësi për të punuar në atmosferë interdisciplinare;

Agjencia e Statistikave të Kosovës, mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Konkursi është i hapur 5 ditë kalendarike nga dita e publikimit në media dhe në web faqen e ASK-se.

Paraqitja e kërkesave: Formularët për aplikim mund të merren në Arhivin e ASK-se, ose mund të tërhiqen nga web faqja e ASK-së në adresën <http://ask.rks-gov.net/>.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, Rr."Zenel Salihu" nr.4 Prishtinë.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrihen intervistës me gojë.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit, në tel: 038- 20031149, prej orës 08:00 – 16:00.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo
Agency of Statistics

Na osnovu člana 8. stava 3.1, člana 6, stava 5 i člana 33 Zakona br.04 / Z-036 o Zvaničnoj Statistici Republike Kosovo, Administrativnog Uputstva br.08 / 2012 o Uslovima i Načinu Pružanja Statističkih Podataka Dobijenih Posebnom Obradom Zvaničnih Statistika i člana 12 stava 4 Zakona br. 03 / Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosovo, Zakona br. 04 / Z-077 o Obligacionim Odnosima, Agencija za Statistiku Kosova, raspisuje:

Javni Konkurs o Sporazumu za Posebne Usluge

Naziv institucije:	Agencija za Statistiku Kosova
Naziv pozicije:	Razvijatelj/Developer Aplikacija
Referentni broj:	ASK-OMIT-001
Tarifa usluga:	950 Evra (Bruto)
Izveštava:	Šefu IT Divizije
Vrsta ugovora:	Sporazum za Posebne Usluge (SPU)
Trajanje ugovora:	2 meseca
Radno vreme:	Puno ?
Lokacija i broj izvršilaca:	ASK-1

ASK, odnosno Odeljenje OMIT-a je u procesu izgradnje sistema za Upravljanje Metapodacima. Ovaj sistem će biti kompatibilan sa Eurostatovim sistemom koji će omogućiti ASK-u da prenosí nacionalne metapodatke Eurostatu kroz sistem Metadata Handler (ESS-MH), i kao takav će biti kompatibilan sa SDMX-om. Sistem će generisati datoteke metapodataka u .xml formatu u skladu sa SDMX kako bi se olakšala veza sa ESS-MH.

Da bi ASK ispunila ove ciljeve, raspisala je konkurs za jedan Razvijatelj (developer) aplikacija.

Zadaci i odgovornosti:

- Koordinira i pruža pomoć u kreiranju strukture i sadržaja SDMX podataka;
- Suraduje sa vođom projekta za metapodatke kako bi se osiguralo da su sva tehnička pitanja rešena;
- Pomaže u pokretanju novih projekata razmene podataka u SDMX formatu;
- Učestvuje u radnoj grupi SDMX-a i specifičnim podgrupama vezanim za radne zadatke. Ovo uključuje saradnju sa GOPA podugovornim stručnjacima Eurostata za izradu smernica i dokumenata najboljih praksa za korišćenje SDMX-a;
- Uz pomoć i nadgledanje od strane odgovornog IT službenika ASK-a će razviti bazu metapodataka na posebnom serveru specijalno posvećen za tu svrhu;
- Sučelje/Interfejs će biti baziran na ESMS i ESQR;
- Sučelje/Interfejs će biti dizajniran i razvijen u prijateljskom sučelju/interfejsu koji će biti lako dostupan;
- Izraditi dokumentaciju projekta;
- Strogo sprovodi mere sigurnosti i planove obnavljanja podataka;
- Pod nadzorom lokalnog IT osoblja, instalira, konfigurira i testira veb aplikaciju na serveru ASK-a;
- Suraduje sa drugim radnim grupama i pomaže u kontroli, upoređivanju, analizi i komentisanju njihovih podataka i rezultata.

Kvalifikacije:

Univerzitetska diploma iz oblasti Informacionih Tehnologija.

Najmanje 4 godine radnog iskustva u relevantnoj oblasti (obavezno).

Kompetencije i veštine:

- Poznavanje jezika kodiranja kao što su: C #, HTML, CSS;
- Napredno poznavanje tehnologije ASP.NET, MVC kao i Microsoft SQL Server;
- Poznavanje standarda SDMX-a prednost;
- Veštine u planiranju, istraživanju i analiziranju, sposobnost da razume procese, da koordinira i organizuje rad;
- Očuvanje poverljivosti;

Agencija za Statistiku Kosova pozdravlja prijave svih muškaraca i žena iz svih zajednica.

Uslovi učešća na konkursu:

Pravo učešća na konkurs imaju svih punoletni građani Republike Kosovo koji imaju punu sposobnost da deluju, koji su u posedu građanskih i političkih prava, koji imaju potrebnu obrazovnu spremu i stručnu sposobnost za obavljanje potrebnih zadataka i koji imaju fizičke sposobnosti potrebne za odgovarajuću poziciju.

Konkurs je otvoren 5 kalendarskih dana od dana objavljivanja u medijima i na veb-stranici ASK-a.

Podnošenje prijave:

Obrasci za prijavu mogu se dobiti u Arhivi ASK-a, ili se mogu preuzeti sa veb-stranice ASK-a: <http://ask.rks-gov.net/>. Aplikacije se uzimaju i dostavljaju u Agenciju za Statistiku Kosova, Ul."Zenel Salihu" br.4, Priština.

Uz prijavu potrebno je priložiti: Kopiju lične karte, kopije dokumenata o kvalifikaciji i drugih dokumenata potrebnih za posao za koji se prijavljujete.

Nepotpune prijave i one *podnete* nakon isteka roka neće biti prihvaćene

Zbog velikog broja primljenih prijava, samo kandidati koji uđu u uži izbor biće kontaktirani.

Kandidati koji uđu u uži izbor biće usmeno intervjuisani.

Za dodatne informacije možete kontaktirati Kancelariju Osoblja na broj telefona: : 038- 200 31 149 od 08:00 – 16:00 časova.


Vendlindja nderon Prof. dr. Eqrem Zenelajn

THEKANDË, 29 MAJ (ER) - Shkolla Fillore e Mesme e Ulët "Dëshmorët e Grekocit" nga fshati Grekoc i Therandës dhe (e mërkurë) i ka bërë pritje madhështore prof. dr. Eqrem M. Zenelajn, të cilit i ka dhënë mirënjohje me motivacion për kontributin dhe mbështetjen e pakursyer për promovimin e vlerave kombëtare si profesor, shkencëtar, frymëzues dhe, mbi të gjitha, personalitet me virtyte të larta njerëzore. "Ndihe mi krenarë që ishit nxënës i shkollës sonë. Sukseset dhe të arriturat tuaja e ngrehin lart edhe shkollën tonë", thuhet në mirënjohjen e ndarë nga drejtori i shkollës "Dëshmorët e Grekocit", Naser Kurtishaj. Pasi profesor Zenelaj, i cili ka

qenë i shoqëruar nga Prof. Dr. Selim Daci, Prof. dr. Muhamet Mala si dhe drejtori i gazetës "Epoka e re", Sadik Zeqiri, u është bërë pritje madhështore në shkollën e fshatit Grekoc. Pritja u është organizuar nga mbi 400 nxënës sa ka kjo shkollë si dhe nga i gjithë stafi i mësimdhënësve të shkollës. Gjatë pritjes atyre u është shtruar edhe një drekë me ushqime tradicionale të cilën e kishin përgatitur mësueset e shkollës. Për kontributin e profesor Zenelajit kanë folur Profesor dr. Daci dhe Profesor dr. Mala si dhe drejtori i shkollës, Profesor Kurtishaj. Pas pranimit të mirënjohjes nga drejtori i shkollës si dhe disa dhuratave simbolike, edhe profesor Eqrem Zenelaj



secilit prej mësimdhënësve të shkollës u ka dhënë disa prej librave të vet që ka botuar ndër vite. Profesor dr. Eqrem Zenelaj i premtoi drejtorit të shkollës "Dëshmorët e Grekocit" dhe mësuesve të kësaj shkolle, se me vetëkontribut do t'ua sigurojë një bibliotekë, po ashtu u zotua se në ditën e shkollës do të organizojë një ekspozitë me mbi 100 portrete dhe gravura të cilat i ka mbledhur në 20 arkive me të vjetra të Europës dhe Austrisë. Për nder të profesor Zenelajit shkolla ka organizuar një program kulturor-artistik, të cilin e ka udhëhequr mësuesja e muzikës, Ardhmërie Baraliu. Ndërkaq, një shënim për jetën e profesor Zenelajit dhe për krijimtarinë e tij shkencore e ka lexuar arsimtari Fikret Ramaj.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"

TEL: 045 82 82 82

Shala: Jua tregoj projektin e ri të Istogut

Trajneri Faruk Shala në këtë intervistë për "Epokën e re" ka thënë se KHF Istogu, pas sukseseve të arritura në këtë edicion, në një periudhë prej tri vjetësh do të jetë skuadra e parë nga Kosova që do të marrë pjesë në garat e Ligës së Kampionëve. Për edicionin e ri, Shala konfirmoi se synohet mbrojtja e të dy trofeve të fituar në kampionatin që përfundoi javën e kaluar

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 29 MAJ - Trajneri i KHF Istogu, Faruk Shala, e vlerëson edicionin e sapopërfunduar shumë të suksesshëm për skuadrën e Istogut për faktin se e ka kompletuar planin dyvjeçar. Trajneri Shala në këtë intervistë për "Epokën e re" ka zbuluar se është hartuar një plan i ri që kampionia e re e Kosovës të bëhet skuadra e parë që do të marrë pjesë në garat e Ligës së Kampionëve. Ne e kemi hartuar një projekt trevjeçar të cilin ia kemi prezantuar ministrit Kujtim Gashi dhe kemi marrë përkrahjen e tij për zhvillimin dhe ngritjen e mëtutjeshme të KHF Istogu, kurse këtë projekt ia kemi paraqitur edhe kryetarit të Komunës së Istogut, Haki Rugova. Projekti ynë parasheh që në afat prej tre vjetësh të ndërtojmë një skuadër që do të jetë e para që do të marrë pjesë në Ligën e Kampionëve", ka thënë Shala.

"Epoka e re": KHF Istogu e përmbylli një edicion fantastik. Pas paraqitjes dinjitoze në garat ndërkombëtare, arritët ta fitoni Kupën dhe titullin në rrafshin vendor. Sa ishte i vështirë ky rrugëtim deri te këto suksese për skuadrën tuaj?
Shala: Ky është viti më i suksesshëm i Klubit të Hendbollit Istogu. Me fitimin e titullit të kampionit të Kosovës e kemi përmbyllur një projekt dyvjeçar, ku kemi planifikuar që në afatin prej dy vjetësh të ndërtojmë një skuadër dominuese në hendbollin e Kosovës. Projekti ynë është realizuar 100 % ngaqë kemi fituar të gjithë trofetë e mundshëm dhe kemi qenë superiorë ndaj skuadrave të tjera në vend. Gjithashtu, kemi arritur të eliminojmë skuadra shumë me përvojë në kupat evropiane, duke qenë pjesë e 16 ekipeve më të mira në Evropë në Challenge Cup. Këtu me pak fat ndoshta kemi mundur të japim edhe më shumë, por janë paraqitur kanë disa pengesa teknike. Përpos përfaqësimit dinjitoz, në kupat e Evropës kemi përfituar një përvojë të jashtëzakonshme, e cila do të na shpërbejë shumë në paraqitjet tona në të ardhmen. Natyrisht se arritja e tërë këtyre rezultateve ka qenë shumë e vështirë. Ky ka qenë kampionati më i mundimshëm për ne, por kemi arritur të gjitha synimet tona. Ky doli të jetë kampionati i krenarisë për ne dhe qytetin tonë. Me këtë përfundon një kapitull, por fillon një epokë e re për KHF Istogu.

"Epoka e re": Sa ju ndihmoi në rrugëtimin drejt këtyre sukseseve përkrahja e madhe nga qyteti i Istogut, por edhe vlerësimi dhe respekti nga mbarë Kosova?

Shala: Të arriturat ishin më shumë mund dhe sakrificë, duke marrë parasysh rrethanat në të cilat ka kaluar klubi ynë dhe faktin që jemi një qytet i vogël që nuk kemi pasur suksese të mëdha në cilësi të klubeve dhe për të arritur që hendbollin ta bësh sport të dashur në komunë është dashur shumë angazhim, vit pas viti me punë dhe rezultate, hendbolli femëror në qytet



është bërë sporti numër një në komunë. Tani qytetarët istogas jetojnë me krenarinë që kanë klubin më të mirë në vend, bashkëndiejnë të gjitha sukseset dhe rezultatet tona. Kjo ka bërë që të rritet përkrahja nga qytetarët, prindërit, bizneset dhe institucionet.
Paraqitja e hendbollistëve me një elegancë dhe edukatë të veçantë, qoftë në ndeshjet e nivelit shtetëror dhe atij ndërkombëtar dhe rezultatet e mira të tyre, ka bërë që klubi ta fitojë simpatinë dhe përkrahjen jo vetëm të qytetarëve istogas, por të gjithë Kosovës. Ky fakt është e arritura më e madhe për ne.

"Epoka e re": Keni përmbyllur një mision të suksesshëm. Ju lutemi, na shpjegoni më konkretisht se çfarë përmban projekti i radhës i skuadrës së Istogut?

Shala: Ne e kemi hartuar një projekt trevjeçar të cilin ia kemi prezantuar ministrit Kujtim Gashi dhe kemi marrë përkrahjen e tij për zhvillimin dhe ngritjen e mëtutjeshme të KHF Istogu, kurse këtë projekt ia kemi paraqitur edhe kryetarit të Komunës së Istogut, Haki Rugova. Projekti ynë parasheh që në afat prej tre vjetësh

të ndërtojmë një skuadër që do të jetë e para që do të marrë pjesë në Ligën e Kampionëve. Kryetari ka premtuar se do ta gjejë formën ligjore adekuate që të përkrahët klubi dhe të jetë prioritet sportiv në komunë. Gjithashtu, presim mbështetjen e asamblesë komunale, bizneseve dhe qytetarëve istogas. Me përkrahjen e tyre jemi të sigurt që projekti ynë do të jetësohet dhe në afatin prej tre vjetësh ne do të jemi pjesë e grupeve të Ligës së Kampionëve.

"Epoka e re": Sigurisht se synimi i KHF Istogu është mbrojtja e trofeve edhe në kampionatin e ri, por a keni realizuar ndonjë lëvizje për t'ju ndihmuar në këtë rrugëtim?

Shala: Kemi filluar të mendojmë për edicionin e ri të hendbollit, pasi kemi finalizuar marrëveshjet me tri hendbolliste me përvojë që vijnë nga shtetet evropiane. Në vjeshtë presim t'i zhvillojmë ndeshjet në qytetin tonë. Synojmë të jemi prapë kampionë dhe fitues i Kupës dhe ta bëjmë hapin e parë drejt ambicieve të përgjithshme të garave evropiane, pra të kalojmë më shumë runde dhe t'i afrohem sa më shumë fazës finale.

SHKURT

Muhaxheri: Besa, klubi më i mirë në vend

KH Besa Famgas është shpallur ditë më parë kampione e Kosovës në hendboll. Përfaqësuesit e skuadrës kampione janë pritur sot nga kryetari i Pejës, Gazmend Muhaxheri, i cili me këtë rast ka vlerësuar se skuadra pejane edhe një herë e ka konfirmuar se është më e mira në vend. "Kisha kënaqësinë ta pres në zyrë Klubin e Hendbollit KH Besa FamGas, i shpallur kampion i Kosovës në Kampionatin e Hendbollit 2018/19. Klubi i Pejës e konfirmon edhe një herë se është më i miri në vend. Një sukses i radhës i bazuar mbi një organizim serioz të klubit, punë e përkushtuar e sportistëve dhe drejtim profesionist i trajnerëve. Urime djema!", ka shkruar Muhaxheri në "Facebook".

Sulmuesi kamerunas, në prova te Ballkani

Skuadra e Ballkanit, pasi e siguroi mbetjen në IPKO Superligë, ka filluar të mendojë për edicionin e ri. Klubi nga Suhareka ka njoftuar se në prova është sulmuesi nga Kameruni, Effa Lazare Tristan Dylan, i cili ka qenë pjesë e grupmoshave të Përfaqësueses së Kamerunit dhe do të qëndrojë për disa ditë te skuadra për testim nga stafi teknik.

Këto skuadra i 'trokasin' në derë Alidemës

Festim Alidema ka shkëlqyer në edicionin 2018/2019 me fanellën e skuadrës së Llapit, duke qenë ndër më të mirët në ligë. Kjo ka bërë që ofertat në drejtim të tij të janë të shumta te skuadra nga Kosova e Shqipëria, por Alidema synon një skuadër të madhe evropiane. "Kam shumë oferta nga klubet: Partizani, Prishtina, Drita, Feronikeli, Kukësi dhe Shkëndija, por një herë i kam refuzuar dhe jam i interesuar për ofertat e klubeve më të mëdha evropiane", ka thënë Alidema për "Olle".

MKRS-ja, 350 mijë euro për stadiumin e Studenqanit

SUHAREKË, 29 MAJ - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me kryetarin e Komunës së Suharekës, Bali Muharremi, për

financimin e projektit "Stadiumi në Studenqan të Suharekës". "Stadiumi në Studenqan të Suharekës" mbështetet financiarisht me 350 mijë euro dhe pritet të zba-

tohet gjatë viteve 2019-2020, ku edhe mjetet financiare do të ndahen në dy periudha kohore, 150 mijë euro për vitin 2019 dhe 200 mijë euro për vitin 2020", thuhet në njoftimin e

MKRS-së. Pas nënshkrimit të këtij memorandum, ministri Gashi u shpreh se kjo bëhet me qëllim të përmbushjes së kërkesave të rinjve dhe sportistëve të Suharekës.



Gjilani - Besa sot 'luftojnë' për Superligë



PRISHTINË, 29 MAJ - Komisioni i Garave në praninë e përfaqësuesve të klubeve e ka bërë tërheqjen e shortit për ndeshjet e barazhit për IPKO Superligë, ku janë caktuar skuadrat në cilësinë e vendësit. Kjo u ka dhënë mundësi klubeve në cilësi të vendësve që të kenë përparësi për zgjedhjen e ngjyrave të

fanellave si dhe t'i zgjedhin tribunat ku do të vendosen tifozët e tyre pasi, siç dihet, çiftet përcaktohen në bazë të renditjes përfundimtare në Superligë dhe Ligën e Parë.

Ndeshja Gjilani - Besa do të zhvillohet nesër (e enjte). Tifozët gjilanas do të vendosen në tribunën lindore, kurse ata pejanë në tri-

bunën perëndimore. Ndërkaq, në ndeshjen Trepça '89 - Vëllaznimi, e cila zhvillohet të shtunën (më 1 qershor), tifozët mitrovicas do të vendosen në tribunën perëndimore, kurse ata gjakovarë në tribunën lindore. Të dyja ndeshjet zhvillohen në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë dhe fillojnë në orën 16:00.

Ismajli: Nuk jam penduar që kam zgjedhur Shqipërinë, kualifikohemi në Evropian

TIRANË, 29 MAJ - Mbrojtësi i Kombëtares së Shqipërisë, Ardan Ismajli, në konferencë për shtyp para medieve, ka folur për dy ndeshjet eliminatorë që e presin Shqipërinë në qershor. Ai është shfaqur me shumë besim për të marrë pikë ndaj Islandës dhe për kualifikimin. "E njoh shumë mirë futbollin dhe e kam detyrim t'i shohë lojtarët kundërshtarë. Islanda nuk është siç ka qenë dhe ne kemi shpresat tona për të marrë pikë. Për mua nuk ka problem, mund të luaj dhe me tre mbrojtës. Unë besoj se nëse marrim tri pikë me Islandën ka shumë gjasa të kualifikohemi. Mund të mundim dhe Moldavinë dhe kemi gjasa për kualifikim. Do të shkojmë për fitore aty", ka thënë Ismajli, të cilit nuk i ka pëlqyer shumë pyetja se a është penduar që e ka zgjedhur Shqipërinë. "Nuk e di pse ma bëjnë këtë pyetje. Unë jam i lumtur këtu. Shpresoj që ata të kualifikohen dhe ne do të rikthehemi dhe do ta kalojmë shpejt ngërçin.



Nuk jam penduar për këtë zgjedhje", ka shtuar ai. Mbrojtësi Ismajli ka konfirmuar se ka pasur

interesim nga skuadrat e tjera, por që tash është i fokusuar në ekipin kombëtar.

SHKURT

Hoeness, Boatengut: Largohu nga Bayerni

Presidenti i Bayern Munchen, Uli Hoeness, nuk sheh më asnjë arsye përse ish-mbrojtësi i kombëtares gjermane, Jerome Boateng, ta vazhdojë karrierën në Munchen. "Frustrimin që ka tani do ta ketë më shumë në sezonin e ardhshëm nëse vendos të qëndrojë. Ai nuk është një lojtar që pranon të qëndrojë në stol. Nuk është tip që mund ta përballojë diçka të tillë. Këtë e tregoi me sjelljen e tij gjatë finales së Kupës ditën e shtunë, ndaj do të ishte më mirë të largohet", ka thënë Hoeness. "Nuk mund t'i mohosh kontributet që ka dhënë Jerome për skuadrën e Bayernit në gjithë këto sezone, por me ardhjen e Pavardit dhe Herndanezit, mendoj se jemi të kompletuar në repartin e mbrojtjes. Kemi edhe Sulen dhe Hummelsin", ka deklaruar Hoeness.

Katër lojtarë do të largohen nga Unitedi

Sezoni ka përfunduar për Manchester Unitedin, kurse vlerësohet si nga më të dobët në vitet e fundit. Asnjë kupë e fituar dhe paraqitja e turpshme e kanë nxitur stafin drejtues të ndërmarrë masa. Trajneri Solskjaer është njeriu me "dorën e hekurt" dhe vendos ai për lojtarët, që do të mbajë dhe do të largojë gjatë kësaj vere. Sipas "Manchester United Evening News", flitet se do të jenë katër lojtarë të tjerë që do të largohen, pas Antonio Valencias dhe Ander Herrerës. Bëhet fjalë për Mateo Darmian, Alexis Sanchez, Romelu Lukaku dhe Marcos Rojo, futbollistët të cilët do të shiten nga klubi anglez.

Todt: Botërori në Formula 1 mund të mbyllet në gusht

Botërori 2019 të Formula 1 po humbet rivalitetin, teksa Mercedesi po dominon në çdo pistë ku është garuar deri më tani. Ferrari që pritej ta bënte diferencën këtë sezon deri më tani ka zhgënjyer, duke mos qenë në atë nivel që pritej. Presidenti i FIA-s, Jean Todt, ish-drejtues i "kokëkuqes", shprehet: "Një ekip i mirë, por që i mungon pak 'kripë e piper' në përbërësit e saj për të fituar dhe për të qenë kompetitiv. Unë shpresoj që ata ta rikuperojnë sa më shpejt. Nëse gjërat vazhdojnë kështu edhe në 2-3 garat e ardhshme, atëherë Botërori do të mbyllet para kohe, pas pushimeve verore. Më vjen keq ta them, por ky Botëror për momentin nuk po dhuron atë rivalitet që pritej. Vetteli është një pilot që ofron garanci, Leclerc është i ri dhe i talentuar. Edhe makina është deri diku kompetitive, por mungon ai ingredient që t'i lidhë të gjithë përbërësit", ka deklaruar Todt.

Monaco konfirmon trajnerin Jardim, blen edhe Martinsin

Pasi i shpëtoi rënies në Ligën 2 vetëm në javën e fundit, Monaco ka konfirmuar trajnerin Leonardo Jardim edhe për sezonin e ardhshëm në bankinën e ekipit. Skuadra e Principatës e nisi sezonin me francezin Thierry Henry në stol, por pas disa muajsh e pa veten në vendin e fundit, ndaj drejtuesit bënë një hap pas për ta rikthyer portugezin Jardim. Ndërkohë, klubi i Monacos njoftoi se vendosi ta blejë zyrtarisht talentin portugez Gelson Martins. Ky i fundit ishte në huazim nga Atletico e Madridit, por duket se i ka bindur të gjithë me performancën e tij dhe klubi francez ka vendosur të paguajë 30 milionë euro për kartonin e tij.

Barça konfirmon Valverden

Barcelona ka vendosur të vazhdojë me Ernesto Valverden edhe për sezonin e ardhshëm. Bordi i Barcelonës ka besim te trajneri Valverde për ta përsëritur suksesin që ai ka arritur në mbretërimin e tij deri tani me klubin, duke fituar dy tituj të La Ligës dhe një Kupë të Mbretit. "Kjo humbje nuk është për faj të trajnerit", ka thënë presidenti Josep Maria Bartomeu pas humbjes të shtunën ndaj Valencias. "Unë dua ta theksoj vlerën e dikujt që është, në një mënyrë diskrete, duke ndihmuar ekipin tonë. Unë jam duke folur për Ernesto Valverde, të cilit i besojmë plotësisht", ka shtuar ai. Mbështetja e Valverdes nga lojtarët gjithashtu ka qenë e rëndësishme, me Lionel Messin, Gerard Piquen, Jordi Alban dhe Ivan Rakitiqin që kanë shprehur gatishmërinë e tyre të vazhdojnë me spanjollin.

Kërkesa për shprehje të interesit	
Emri i shkollës: "Fehmi Rama"	
Komuna: Skenderaj	
Data: 30.05.2019	
Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/111-CS/1.5	Trajnim: Puna e kujdestarit të klasës
Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shfmu "Fehmi Rama" Likoc, Skenderaj	
Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës	
Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:	
Trajnim: Puna e kujdestarit të klasës	
Kualifikimet e firmës konsulente:	
<ul style="list-style-type: none"> Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore. 	
Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.	
Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme.	
Kriteret e vlerësimit:	
<ul style="list-style-type: none"> Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e ngjashme (40%); Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%); Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%) 	
Procesi i seleksionimit:	
Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).	
Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën Shfmu "Fehmi Rama" Likoc, Skenderaj, më së largu deri më datën; 10.06.2019	
Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.	
Detajet kontaktuese të shkollës:	
Personi kontaktues: Arsim Jusufi	
Telefoni: 044/549-732	
E-maili: arsimjusufi@hotmail.com	

Kërkesa për shprehje të interesit	
Emri i shkollës: "Faik Dragaj"	
Komuna: Skenderaj	
Data: 30.05.2019	
Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/110-CS/1.4	Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie
Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shfmu "Faik Dragaj" Leçinë, Skenderaj . Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës	
Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie	
Kualifikimet e firmës konsulente:	
<ul style="list-style-type: none"> Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit; Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore. 	
Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.	
Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;	
Kriteret e vlerësimit:	
<ul style="list-style-type: none"> Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e teknologjisë informative (40%); Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme apo IT (40%); Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%) 	
Procesi i seleksionimit:	
Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: Shfmu "Faik Dragaj" Leçinë, Skenderaj, më së largu deri më datën; 10.06.2019	
Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.	
Detajet kontaktuese të shkollës:	
Personi kontaktues: Ukshin Haziri	
Telefoni: 044/934-663	
E-maili: ukshin_haziri@hotmail.com	

Kërkesa për shprehje të interesit	
Emri i shkollës: "Ismet Uka"	
Komuna: Skenderaj	
Data: 30.05.2019	
Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/115-CS/1.5	Trajnim: Planifikimi strategjik në funksion të shëndrrimit të shkollave në organizata të fuqishme të nxënësve
Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shfmu "Ismet Uka" Ticë, Skenderaj	
Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës	
Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnim: Planifikimi strategjik në funksion të shëndrrimit të shkollave në organizata të fuqishme të nxënësve	
Kualifikimet e firmës konsulente:	
<ul style="list-style-type: none"> Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore. 	
Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.	
Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme.	
Kriteret e vlerësimit:	
<ul style="list-style-type: none"> Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e ngjashme (40%); Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%); Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%) 	
Procesi i seleksionimit:	
Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).	
Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën Shfmu "Ismet Uka" Ticë, Skenderaj, më së largu deri më datën; 10.06.2019	
Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.	
Detajet kontaktuese të shkollës:	
Personi kontaktues: Hamide Abazi	
Telefoni: 044/588-596	
E-maili: hamideabazi.86@hotmail.com	

Kërkesa për shprehje të interesit	
Emri i shkollës: "Kuvendi i Drenicës"	
Komuna: Skenderaj	
Data: 30.05.2019	
Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/116-CS/1.3	Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie
Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shfmu "Kuvendi i Drenicës" Abri e Poshtme, Skenderaj . Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës	
Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie	
Kualifikimet e firmës konsulente:	
<ul style="list-style-type: none"> Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit; Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore. 	
Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.	
Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;	
Kriteret e vlerësimit:	
<ul style="list-style-type: none"> Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e teknologjisë informative (40%); Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme apo IT (40%); Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%) 	
Procesi i seleksionimit:	
Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: Shfmu "Kuvendi i Drenicës" Abri e Poshtme, Skenderaj, më së largu deri më datën; 10.06.2019	
Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.	
Detajet kontaktuese të shkollës:	
Personi kontaktues: Smajl Behramaj	
Telefoni: 044/164-131	
E-maili: smajl_behramaj@hotmail.com	

Kërkesa për shprehje të interesit
Emri i shkollës: "Enver Haliti"
Komuna: Skenderaj
Data: 30.05.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/109-CS/1.4	Trajnim: Gjithëpërfshirja

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe "Enver Haliti" Lubovec, Skenderaj.

Objekti i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës.

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulentëve të nevojshme: Trajnim: Gjithëpërfshirja

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhitën në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme.

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve nga fusha e Gjithëpërfshirjes (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përgjedyja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përgjedyjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën "Enver Haliti" Lubovec, Skenderaj, më së largu deri më datën: 10.06.2019

Firmat e interesuara të konsulentëve mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Sami Bekteshi
Telefoni: 044/532-563
E-mail: bekteshisami@hotmail.com



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të nenit 66 dhe 67 të Ligjit nr. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Rregullores nr. 01/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Rregullores nr. 03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Proueve, në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretariatit i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës

- KOZ-16/2019 Zvrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Gjakovë,
- KOZ-17/2019 Zvrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Dragash
- KOZ-18/2019 Zvrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Istog
- KOZ-19/2019 Zvrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Klinë
- KOZ-20/2019 Zvrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Skenderaj
- KOZ-21/2019 Zvrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Shtërpce,

Grada/Koeficienti: Niveli Profesional- G6 -13.5 / Mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë: Drejtori i Departamentit të Koordinimit në Teren Kohëzgjatja e emërimit: Pa afat, pas periudhës provuese 1(një) vjeçare

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të vendit të punës:

- Kryesori Komisionit Komunal / Zgjedhor në bashkëpunim të plotë me Sekretariatit e KQZ -së;
- Mbikëqyrësi dhe u cakton detyra anëtarëve të tjerë të KQZ -së;
- Mbikëqyrësi punën e trupave zgjedhore në komunën përkatëse;
- Bën raporte për aktivitetet në periudhën zgjedhore dhe jo zgjedhore;
- Koordinon aktivitetet në mes KQZ-së dhe Administratës Komunale dhe SKQZ-së;
- Informon SKQZ-në, lidhur me kërkesat e Kuvendit Komunal për zëvendësimet e këshilltarëve komunal;
- Ndihmon dhe këshillon subjektet politike dhe organizatat joqeveritare për zgjedhjet;
- Kryen detyra të tjera kur i caktohen nga mbikëqyrësit e drejtëpërdrejtë.

Kualifikimi, aftësitë dhe përvoja e punës:

- Të ketë Diplomë Universitare në Drejtësi, Shkenca Politike dhe Administratë Publike;
- Së paku katër (4) vite përvojë pune;
- Integritet të lartë personal dhe profesional;
- Shkathtësi të shkëlqyera në komunikim me gojë dhe me shkrim në gjuhët zyrtare;
- Aftësi dhe gatishmëri për të punuar në mënyrë të paanshme dhe me njerëz të përkatësive të ndryshme etnike;
- Njohje e gjuhës tjetër zyrtare dhe dëshirueshme;
- Njohja e gjuhës angleze e dëshirueshme;
- Njohje të teknologjisë informative (MS Word, MS Excel dhe MS Access);

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Zyra e Personelit, dhoma nr. 21, kati I-rë, Ish Ndërtesa e Bankës së Ljubanës, Rruga "Migjeni" 10000 Prishtinë. Aplikacionet mund të dorëzohen edhe në formë elektronike të skenuara në adresën elektronike: zyra.personeli@kqz-ks.org.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në numrin e tel: 038-200-23-557, prej orës 08:00 – 16:00, ose vizitoni ueb faqen e KQZ-së, në linkun: www.kqz-ks.org. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 4 ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurroni, certifikatën që nuk jeni nën hetim si dhe dy formularët e fundit të vlerësimit nga institucioni ku keni punuar.

Kandidatët duhet të jenë persona me të drejtë vote në komunat e tyre përkatëse.

Kandidatët të cilën hyjnë në përgjedyje të ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose nëpërmjet telefonit nga zyra e personelit. Kandidatët të cilët do të jenë të përgjedytur dhe të ftuar në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale. Afati i konkursit është 15 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor, prej datës: 30.05.2019 deri me datë: 13.06.2019 në ora 16:00. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe inkurajon aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, si dhe pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë, përfshirë personat me aftësi të kufizuara.



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opština Dragas/Dragas Municipality
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM




Nr.13/328
Më: 29.05.2019
D r a g a s h

NJOFTIM PËR PËRMIRËSIM TË KONKURSIONIT

Në konkursin e shpallur me datë 28.05.2019, me nr. protokoli 13/324 dhe publikuar në gazetën "Epoka e Re" me datën 29.05.2019, për shkollën SHFMU "Ulina", është lëshuar një gabim teknik, ashtu që në vend të "SHML" shenohet: SHFMU "Ulina" Kosovë

Datë: 29.05.2019
Dragash



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Shodno članovima 66. i 67. Zakona br. 03 / L-073 o opštini izborima u Republici Kosovo, Uredbe br.01/2017 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u Sekretarijatu Centralne Izborne Komisije, Uredbom br. 03/2017, o procedurama regrutacije, imenovanja i probnog rada u Sekretarijatu Centralne izborne komisije, Sekretarijat Centralne Izborne Komisije objavluje:

KONKURS

Za popunjavanje slobodnih radnih mesta

- CIK-16/2019 Viši Službenik Opštinske Izborne Komisije u Đakovici,
- KOZ-17/2019 Viši Službenik Opštinske Izborne Komisije u Dragashtu
- KOZ-18/2019 Viši Službenik Opštinske Izborne Komisije u Istoku
- KOZ-19/2019 Viši Službenik Opštinske Izborne Komisije u Klini
- KOZ-20/2019 Viši Službenik Opštinske Izborne Komisije u Srbici,
- KOZ-21/2019 Viši Službenik Opštinske Izborne Komisije u Štrpcu,

Stepen / Koeficient: Profesionalni nivo-G6 - 13.5
Direktni Nadzornik: Direktor Odeljenja za Koordinaciju na Terenu
Vreme trajanja imenovanja: Neograničeno, uključujući i period probnog rada 1 (jednogodišnji)

Glavni zadaci i odgovornosti radnog mesta:

- Predsedava Opštinskom izbornom komisijom, u potpunosti saradnji sa Sekretarijatom CIK-a;
- Nadgleda i određuje zadatke drugim članovima OIK-a;
- Nadgleda rad izbornih tela u svojoj opštini;
- Priprema izveštaje o aktivnostima u toku izbornog i ne-izbornog perioda;
- Koordinira aktivnosti između OIK-a, Opštinske administracije i SCIK-a;
- Informiše SCIK u vezi sa zahtevima Skupštine opštine za zamenu opštinskih odbornika;
- Pomaže i daje savete političkim subjektima i nevladinim organizacijama u vezi sa izborima;
- Izvršava druge zadatke koji mu se odrede od strane direktnog nadzornika.

Kvalifikacija, sposobnosti i radno iskustvo:

- Univerzitetska diploma iz oblasti prava, političkih nauka i javne administracije;
- Najmanje četiri (4) godine radnog iskustva;
- Visok lični i profesionalni integritet;
- Odlučne veštine usmene i pismene komunikacije na službenim jezicima;
- Sposobnost i spremnost da radi nepristrasno sa ljudima različite etničke pripadnosti;
- Pozeljno je poznavanje drugog službenog jezika.
- Pozeljno je poznavanje engleskog jezika.
- Poznavanje informativne tehnologije (MS Word, MS Excel i MS Access);

Aplikacije se mogu preuzeti i predati u Sekretarijatu Centralne Izborne Komisije, Kadrovska kancelarija, Kancelarija br.21, sprat I-vi, bivša zgrada Ljubljanske Banke, Ulica "Migjeni" 10000 Prishtina. Aplikacije se mogu predati i u elektronskom obliku na adresi: zyra.personeli@kqz-ks.org. Za detaljnije informacije, možete stupiti u kontakt sa osobom Kadrovske kancelarije na br. tel.: 038-200 23 557, od 08:00 – 16:00, ili posetite web-stranicu CIK-a, na linku: www.kqz-ks.org. Aplikacije poslate putem pošte, na kojima je poštanski pečat pošiljke sa datumom zadnjeg dana konkursa, će se uzeti u obzir i razmotriti, ukoliko iste pristignu u roku od 4 dana. Aplikacije koje pristignu nakon ovog roka i nekompletirane aplikacije se neće uzeti u obzir. Aplikaciji priložite kopiju dokumentacije o vašim kvalifikacijama, radno iskustvo i ostalu neophodnu dokumentaciju koja se zahteva za ovo radno mesto za koje vi konkurirate, potvrda da niste pod istragom kao i dva zadnja obrasca vašeg ocenjivanja iz institucije u kojoj ste ranije radili. Kandidati trebaju da budu osobe sa pravom glasa iz odgovarajuće opštine. Kandidati koji uđu u izbor o intervju će biti informisani pismeno ili putem telefona u umtar zakonskog roka od strane kadrovske kancelarije. Kandidati koji budu izabrani za učešće na intervju dužni su da sa sobom ponesu originalna dokumenta. Rok konkursa je 15 dana od dana objavljivanja u dnevnoj štampi, od dana: 30.05.2019 - 13.06.2019 u 16:00 časova. Centralna Izborna Komisija pruža jednake mogućnosti za zapošljavanje svim građanima Kosova i podstiče prijave svih osoba muškog i ženskog roda, kao i pripadnika svih zajednica na Kosovu, uključujući osobe sa ograničenim sposobnostima.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



Nr. I-180/03/19
Junik
Dt.30.05.2019

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, neni 17, të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, neni 5 pika e.d të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ Procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues numër 08/2014, datë, 25.02.2014, neni 2 pika 1,2,4, dhe Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Statutit të Komunës, Komuna e Junikut shpallë:

K O N K U R S

- I. Për përzgjedhjen e Drejtorit të Shkollës në Gjimnazin “Kuvendi i Junikut” në Junik,

Kualifikimet, shkathësitë, aftësitë dhe përvoja:

- ✓ Kërket Kualifikimi i arsimit universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitarë), nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore;
- ✓ Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedurë të licencimit;
- ✓ Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim.
- ✓ Të ketë së paku 3 vjet përvojë pune në arsim ose në institucione të arsimit.

Të posedojnë këto dokumente;

- Certifikatën e lindjes;
- Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës;
- Dëshminë për përvojën e punës;
- Protokollin profesional;
- Letër referencë nga një institucion publik-kredibil (MASHT, DAKRS, Këshilli drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë)
- Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake;
- Plani zhvillimor të institucionit edukativo-arsimorë dhe aftësues për të cilin ka konkuruar (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12)
- Njohuri në përdorimin e kompjuterit dhe të programeve themelore të
- Microsoft Office (dëshmi nëse ka);
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore
- Dëshminë se nuk është nën hetime.

Detyrat kyçe:

- Përpunon dhe koordinon lëndët, informatat, organizon ecurinë e punëve, takimeve ditore dhe prezantimeve dhe përpunon dokumentacionin e drejtpërdrejt që ka të bëjnë me procesin edukativo-arsimor;
- Kujdeset për komunikim me palët dhe për komunikim elektronik me akterët relevantë;
- Asiston në përgatitjen e dokumentacionit dhe materialeve të nevojshme të kërkuara nga i tërë personeli i shkollës, DAKRS MASHT-it, si dhe për Bordin e shkollës;
- Bën kontrollimin profesional të cilësisë mësimore, organizative në të gjitha nivelet arsimore në bashkëpunim me trupat e tjera të institucionit, DAKRS, MASHT-it;
- Drejtori i shkollës të punojë së bashku me stafin dhe shërbimet tjera që të sigurojë arsim cilësor për të gjithë nxënësit;
- Drejtori i shkollës, së bashku me Bordin e shkollës, këshillin e shkollës DAKRS do të përgatitë dhe menaxhojnë autonominë financiare të shkollës sipas formulës së financimit;
- Të kryen punë dhe detyra tjera që i ngarkohen nga DAKRS dhe MASHT-i në interes për shkollën;
- Harton planin mësimor dhe orarin mësimor.
- Koeficienti: 8.4
- Orari i plotë

Dokumentet e pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim;
Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen;

Kandidatët aplikacionin (formularin për konkurim) mund ta tërheqin në zyrën e pritjes Komuna e Junikut ku edhe i dorëzojnë aplikacionet e plotësuar;

Afati për paraqitjen e dokumentacionit është 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në gazetën ditore, Për ditën e testit, kandidatët do të njoftohen me kohë përmes telefonit.

Udhëheqësja e personelit:
Venera Shala



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansija - Ministry of Finance

Ministria e Financave, mbështetur në Ligjin nr. 03/L-149, “Për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës”, dhe Rregullores nr. 02/2010, “Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil”, me qëllim të realizimit të procedurave të rekrutimit për pozitën e caktuar, Shpallë këtë:

KONKURS

I. Divizioni për raportim Financiar

Titulli i pozitës: Analist i lartë standardeve të Auditimit (1 pozitë)
Numri i referencës : 17/2019/ DRF/MF
Grada e vendit punës: Niveli profesional
Koeficienti: 8

Detyrat dhe Përgjegjësit:

- Harton planin e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të Divizionit për raportim financiar dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e objektivave të njësisë;
- Kryen detyrat e parapara në planet e punës të miratuara, brenda afateve kohore të caktuara;
- Siguron dhe i mban të azhurnuara Standardet e Auditimit duke pasur parasysh nevojën dhe mjedisin afarist në Kosovë;
- Analizon nevojën e mjedisit afarist për të hartuar dhe azhurnuar ndonjë standard të ri dhe analizon aplikimin e standardeve të aprovuara, si dhe sipas nevojës ndërmer masa konkrete;
- Ofron mbështetje teknike dhe profesionale për KKRF, Bordit mbikëqyrës publike apo të komisioneve përkatëse, edhe duke ofruar këshilla në fushën e ekspertizës së kërkuar;
- Kujdeset për regjistrin e auditorëve dhe firmave të Auditimit;
- Koordinon punën me pjesët e tjera të institucionit dhe komunikon, sipas nevojës me autoritete e jashtme;
- Kryen edhe punë dhe detyra tjera të cilat mund të kërkojnë kohë pas kohe nga mbikëqyrësi i drejtë për drejtë;
- Raporton për punën dhe aktivitetin në baza të rregullta sipas kërkesave.

Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Njohuri të thella dhe të specializuara në fushën profesionale specifike, të fituar përmes arsimit universitar;
- Njohuri të legjislativës të aplikueshëm për fushën e Auditimit;
- Aftësi në zgjedhjen e problemeve për çështjet teknike, profesionale ose procedurale që dalin nga procesi i punës;
- Aftësi për të organizuar punën, koordinuar, punuar në Grup dhe puna në presion;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulimin e rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, power point, Access);
- Diplomë Universitare, Fakulteti ekonomik ose administrim biznesi ;
- Minimum tre (3) vite përvojë pune profesionale ;

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Ministria e Financave ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacionit duhet ti bashkëngjiten dokumentet përcjellëse si vijon: Formulari i plotësuar i aplikimit, Dëshminë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomë e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i), letërnjoftimin, Dëshminë e përvojës së punës dhe dy referenca.

Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (rruga Nëna Tereza p.n.). Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni edhe në Web faqen : mfrks-gov.net

Dokumentacioni duhet të dorëzohet në Divizionin e burimeve njerëzore, Ndërtesa e Qeverisë, kati i XII, zyra nr. 1207.

Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.

Kohëzgjatja e emërimit sipas LSHC, duke përfshirë periudhën e punës provuese 1 vjeçare.

Afati i konkurrimit është prej datës 30/05/2019 deri me datë 13/06/2019, deri në orën 16:00.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 038/200/34/196; 038 200 34 155.



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë/Ministarstvo za Inovacije i preduzetništvo/ Ministry of Innovation and Entrepreneurship

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës L. Nr. 03/L-149 dhe Rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës bënë:

Shpallje e Rekrutimit

Departamenti i Ndërmarrësisë

Numri i Konkursit: APF0005411

Vendi i punës: Udhëheqës i Divizionit të Ndërmarrësisë

Koeficienti : 9.00

Kohëzgjatja e Emërimit: Pa afat të caktuar

Mbikëqyrësi: Drejtori i Departamentit të Ndërmarrësisë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

